BKSH

BKSH

ASDREN

PSALLME MURGU

VJERSHA

BKSH

BUKURESHT
1930

BKSH

DASHAMIREVE

BRENDA E JASHTE SHQIPERISE

ME NDIHMEN E TE CILEVE U-SHTYP KY LIBER, PIKSEPARI E NDJEJ PER DETYRE QE NE KRYE KETU, T' U SJELL FALENDERIMET E MIJA MÊ TE THELLA DHE MIRENJOHJE PER MIREDASHJEN E VEÇANTE QE PATNE DEFTYER PER TE DALE KJO VEPER NE DRITE.

AUKTORI

BIBLI

BKSH

VJERSHAVE TE MIJA

Prap ju kujtova, vjetesh krejt harruar
Si gjê të vjejtur rall e tek q' e gjen,
Ju shkunda, letra, dorës s' íme shkruar
Njëj gjumít, munt q' as juve s' ju pëlqën.

Ju mblodha, vjersha, nga ju kísha lênë
E një nga një ju pashë prap me mall,
Më dridhej dora si njëj të pa-ngrênë
Që dridhet pas ca buke q' e sheh rall.

Ca jush prej kohës gjíth me skajet brejtur
Qysh brehet zemra keq kur send e pik,
Disà me faqet shuar, sërët mvrejtur
Si shênjtër kíshe, motí q' í ka fík.

Me ju, përmênda jetën e kaluar
Në radhët shkruar pashë shpírtín t'ím,
Me pika lotesh zemre së lënduar
Mi ju të thara, mbetur sí Kujtím.

Ndër ju sa çase gazí dhe pikllími
Sa dríthma trupí s' pata ndjehur plot,
Kur shíhnja në ç'do radhë dorëshkrími
Hír dashamírí, hír që s'e gjej dot.

* * *

Kur nj' ânkth përbrênda do s'më lè qetuar
Dhe dua t'a përball që në fíllím,

Fët pêndën marr, e vargut duk' í-a shtruar
Pa dashur vargu ndrohet në këndím.

Nër kêngë dhembjes bàrín í-a kam gjetur
Me 'to trishtímín munda që t'a shterr,
Qysh zêrí-í njëj vjolíje tíngëll-fjetur
Ç'do brengë sí me dorë që t'a merr.

Ju pata në kujdes sí fletë lulesh
Nër líbra q' í vendos me dhempshurí,
Dhe sí njëj korës herë q' í përkulesh:
Nj'ashtu dhe jush përpara po ju rrí.

Sí gjê të shtrênjtë, vjersha, ju kam mbledhur
Nuk doja zjarrít jush t'í jap ushqím,
As copë-copë n'erë për t'ju hedhur
T'a shoh të tretur kaqë mallëngjím.

Ju rojta sí dhe vehten ç'do reziku.
Nga palat mos ju dalë mê rënkím,
Sa kíní përkujdesjet njëj kreshníku
Që veç nër ju ka gjetur ngushëllím.

Jo, kurr' o vjersha s' kam për t'ju harruar
Se jûsh ka dalë tínglli-í zêrít t'em,
Dëshír' e zemrës s'íme dhempshuruar:
Nër ju q'e lè sí pêng kur të mos jem!

FLAGA E VATRES

BKSH

BKSH

GJUHA SHQIPE

Lavdí nër shekuj pâtsh, o gjuhë shqípe
Lavdí për ty që jetë merr të rè,
Me tingllín t'ênd të kândshëm kulmín híp-e
Nër shoqet sot krenare zên'e mpreh.

Sí detí-í rahur valash katallane
Kur vjen shtërgata rrebtë q' e sulmòn,
Dhe tí pas aq sulmímesh prej ç'do ane
Sí shkêmb í fortë shekujt í qëllòn.

E vdekur s' íshe, gjuhë stërgjyshore,
Me ty gjallòj një Komb trím e krenàr,
Që s' u-përkùl nër kòhëra mírore
Q'armíqtë rreth, e merrnín drejt barbàr.

Me ty, s'u-shkruan líbra, përmêndore
Sí pêndë, pate shpatën për shkëlqím;
Me tyn' u-líntnë Fryma Ngadhënore
Q'u-shtríhtën lark në Líndje-e Perëndím!

Tí je thesarí príndrít që na lanë;
Sí Leka, Burrí, pas dhe ç'do luftàr,
Nër kêngë-e valle zonja hír të dhanë:
Me tyn' u-mburr Pellasgu mílënar.

Tek ty qendron virtutí-í gjíndjes s'onë
Tí t'arthmen me të shkùarën bashkòn,

Ti na tregon se ç' jemi për gjithmonë
Kur verbi-i yt i bukur na tingllòn!

Bekuar qofshin gjith atà të lumit
Që bres pas brezit goja s'u pushoj
Të gjallë që të mbajtnë; për të shumit
Që Ngjallja jote-aspak nër mênt s'u shkoj.

Si Zonjë-e madhe mbaj-u kryenaltë
Bêj të gjëmojë zêri-i yt hyjnòr,
Nër vepra fryme mêndje mê së naltë
T' i-a thonë Zânat kêngës mi Tomor!

BKSH

HYMN KOMBETAR

Përpara djem, për fis' e farë
Për trollin shënjt ku kemi lé,
Me nder si burrat e më parë
Të mprojmë flamur e atdhè!

O bij t'atdheut, o bij të Shqipërisë
Shqiponja malí mveshur triměrí,
Sí burrat e pa lodhur të lírisë
Nër lufta t'ashpra, luftë për lírí,
Tregoní se krahnorí í djelmurisë
Mburonjë që dhe mbetet përsëri!

Kujtoní Lekët t'an' e kohës shkuar
Kujtoní trímat sa na bënë nder,
Dëshmorët që me gjakun e bekuar
Mí flamur nalt Lírin' e kanë tjer!
Për 'të nj' aq mëm' e vajza janë shuar
Me syt në lot' e zemrat gjíth në vrer!

Fatosat zê na çojnë sot prej varrít
Gjíthmon' t'a kemí mëndjen për atdhè,
Mos mbetet gjurmë kêmbës njëj barbarít
Atje ku trupí, hírí-í tyre flè!
Ku kënga çel e zogut të shqíptarít:
Esht toka jon' ësht besa jon' e fè!

Armiqtë mënt t' i mbajn' atà të parit
Pastaj t'a ndehin dorën për rëmbim,
Për t'a coptuar tokën e shqiptarit
Ku gjakun e ka derdhur pa kursim.
Se mjaft i dhamë ndihmë ç'do rrugtarit
Mjaft vehten t' on' e lamë në mjerim.

Sot Zâna kêngë thur prej qjellit çuar
Sot end kurorë rrezesh djell' i ri,
Ngjat zallit, detit t' onë t' ameshuar
Nër fush' e male zbarth nj' ajo liri
Pa prâ me krahun mjaft q'e kemi mpruar
Të ngjallim kombin, mëmën Shqipëri.

O bij t' atdheut, o bij të Shqipërisë
Shqiponja mali mveshur trimëri,
Si burrat e pa-lodhur të lirisë
Nër lufta t'ashpra, luftë për liri,
Tregoni se krahnori i djelmurisë
Mburonjë që dhe mbetet përsëri!

MALL VELLAZERIJE

Një hije maje kodrës çfaqet
Përtej sy-trembur duket pylli,
Prej drojës unjen manushaqet
Dhe djelli-i lodhur syt' i mbylli.

Lart qielli purpër êsht i mveshur
Tej rehtë gjak sikùr kullojnë,
Mi tokë gjê mê s'sheh të qeshur;
Shigjeta shpirtin t'a dërptojnë.

Prej drítës armët mê s' shkëlqejnë
Kur rrugës trimi shkon kaluar,
Kur shokët qeshin e dëfrejnë
Ay veç duket shpirt-helmuar.

Me mall sheh Mêmën q' e ka líndur
Prej zemrës kêngës don t' i-a thotë;
Por një mejtim e mban të bíndur:
Sikùr s'e nxe mê dot kjo botë.

Një zjar e djek sa zemra-i tretet
Me dorë don të shtrydhë rehtë,
Kur sheh se shpresë mê s' i mbetet
Sa, loti-i shket nga malli-i shrketë.

E njeh se ka një fat të ngratë
Sa zêrí-í shuhet sí-í nguruar,
S'ka prêhje·e gjumë dít' as natë :
Vëllezër qan të robëruar!



BKSH

ADRIATIKUT

I

Të pashë det Adriatik, të pashë
Si Zanë je prej qjellit i pikuar,
Plot me margaritarë je trazuar
Dhe gjiri-i yt plot hire si një vashë.

Më gjunj si Perëndeshe ty të rashë
Për hijet, bukurin' e pa treguar,
Prej gazit math që ndjeva, pa duruar
Me lot për faqe shkova dhe të lashë.

Si ar i derdhur drítët të shkreptíjnë
Pallate prallash çfaqen plot magjíje
Tek valle vajza dredhin mi lendínë.

Të rinj për dorë, tek po ven' e víjnë;
Kujtíme t'êmbla, botë lumërije:
M' u·duk se pashë vetë Perëndínë!

II

O det gji kaltërt, det Adriatik
Si mbret ti je, i bukur, madhështor,
Pra ty të kam vëlla, gjiri dhe mik
E për ç'do ngjarje-e ç' do kujtím dëshmor!

Sa kêngë nuk të thur ç'do vjershëtor
Dettarë sa s' të falen zê mystik,

Porsi njëj Perëndije krejt mythik ;
Sa botë s' bije kot për ty therror !

Por unë ty më tepër t' adhuronj
Më gjunj ty dot t' të falem sa të ronj
Si te një mbret hyjnor, si Perëndi !

Dhe kurdoherë pranë që do shkonj
Si njëj Shënjtorit do t' të ndes qiri :
Se tinë ngjalle zot një Shqipëri !

III

Më rrofsh Adriatik e tungjatjeta
Se ti je Shpëtimtar' i Shqipërisë,
Tek fati i-yt i mvaret shpirti, jeta
Se teje-u-shpallnë rrezet e lirisë !

Di, se Shqiptarët kanë mênt të lehta
Si bisha t' egra çirren prej mërisë,
Nga feja mbetnë róbërit e zisë,
Me syt' e verbër, zemrat gjith të shkreta !

Lum' ti se pranë derës na je ndodhur
Me të pa-reshtur mall na puth atdhenë
Që kur u-linde, çmallesh i pa-lodhur !

Sa kombe syrin ty s' t' a kanë vënë
Sa kêngë dashuríje-atà s' të ngrehnë
Por ti s' na lè, se jetë na ke dhënë !

MALEVE T'ANE

O male krye-madhështorë
Me kreshtat radhas bukur prerë
Dhe majat thurur hyjsh kurórë —
M' i lumt' atij q' i vu me dorë,
Thesàr, që mê s' ju gjendet vlerë.

Ju jini shëmbëll bukurije
Si zot mi nâ ju mbretëroni,
Sikúr një frymë Perëndije
Ju fali nj' aq magji dhe hije
Sa vëndin t'on' e madhështoni.

Prej maj' e rrêze duke nisur
Një dorë mjeshtri ju ka shkruar,
Pëqinjt' e juaj ar qendisur
Me mijra lule të stolisur
Dhe brezash ujit rreth qarkuar.

Nër fushat an' e kênd pjellore
Lumënj të rrebt' e të pa-zbutur,
Me vrull' e vala shkumbëzore
Me zê lahute dhe këmbore
Nga kulmet rendin me t' u-ngutur.

Dhe Deti Nymfë sy-qjellore
Që hyj e qjej në 'të përmblidhen,
Me buzët puthje-u sjell hyjnore

Kur valat tij përkëdhelore
Me drithma dashurije hidhen.

Kur bota mirë nuk qe nisur
Me kafshët, njerzit e shtërpinjtë,
As tokës mjégulla s' qe grisur
Selín' e vet e kishin stisur
Tek ju qëmoti Perëndinjtë.

Ju mproni tokën arbëreshe
Rrufè përcíllni dhe gjëmime,
Me roba mveshur virgjëreshe
Plot madhështije mbretëreshe
Ku rrezet shkrepin mij' shkëlqime.

Në gjinjt' e juaj, male, fshehni
Atdheja ç'do që ka të shtrënjtë,
Ju kêngë trimërije kreni
Ju zemrat burravet u-a ngrehni
Të bíjen fli për trolln' e shënjtë.

Ju male, jíni ndjenja jonë
Burím í ç' dô dëshirës gjallë,
Tek ju e kemi shpresën t' onë
Se kur e keqja vjen, gjithmonë
Me ju, ne do t' í bëjmë ballë.

Nër ju gjen çerdhen kur del trimi
Atdheut rreziku kur í turret,

Prej jush na vjen gjithmòn shpëtimi
Ju na largoni ç' do mjerimi:
Me ju, po, kombi i-ynë mburret.

Me ju së bashku jemi ritur
Në bjeshkat këngë kemi dredhur,
Nër gjinjt' e juaj jemi pritur
Mi bar mëndafshit jemi shtrihtur
Dhe lule malli kemi mbledhur!

Dhe Historin' e kombit t' ënë
Nër brigjet e luginat t' uaj—
Ku pik' e gjakut na ka rënë
Edh' eshtrat t'ona janë vënë;
E kini endur ju, po thuaj!

Stërgjyshrit t'anë të stërvjetër
Kur n'argje-e shpata janë hasur,
Me krerë lisesh apo mbretër
Nërmjèt për një qëllim a tjetër
Tek ju ç'do luftë-e kanë pasur.

Ç'do shkëmb, burim e kodr' a lumë
Dhe sot tregojnë ç'do të ngjarë,
Gjith me kujtime-e pralla shumë—
Sado që mbetur krejt në gjumë
Na thonë syt' ç'u kanë parë.

Mburonjë jini dhe fortesa
Q'as shekujt vëndit mê s'ju tundin,

Për ne ju falí dhe Krijesa
Dhe nesh nërmjet sa ruhet Besa
Askurr' armiqtë s' do t' na mundín!

Prej píkash lotí vese ndritur
Tek ju q'u-derth, ka çel Lirija,
Q'aty shqíponjat kanë zbritur
Hírplót mí Flâmur janë ngjítur:
Q'í pshtjell sot kryet Shqipërija!

BKSH

„FLAMUR TI TE RROSH“

O Flâmur êngjëll-rojë i Kombit t'em
Për Ty ç'do trim gjak derdhi, ra theror,
Nër hovet plot burrnije si dëshmór
E falí shpírtín: Ty t'a prurí qem!

Për ty pra Flâmur gjallë sa të jem
Si shenj' e shênjt' e trollít stërgjyshór
Që na drejton në t' arthmen sí-yll qjellór
Plot kêngë lâvdít gojën do t'a kem!

Se burrat, Teje rreth porsí një mur—
Fortesa të patùndshme në kushtrím,
Krahnorín drras' e vunë pa kursím!

Për lâvdín T'ênd, armíkut kush q' í-u tur
Kur mûndte e bínte, fjalën kísh që thosh:
„Lirí a vdekje, Flâmur Tí të rrosh!“

BASH

LETRE PREJ KATUNDIT T' EM

Urdhëroní, zot, në fshatín t'onë
Me shtëpí të bardha sí gjíthmonë,
Me avllí dhe porta pleqërishte
Gjíth me buzëqeshje dhëndërishte,
Ku drítaret qeshín bukurije
Nga të vëndít lule plot me híje:
Bozílok í gjelbër që mban erë
Që të deh síkundër deh një verë,
Me 'të bashk' e bufka magjístare
Që tërheq me pamjen ledhatare
Dhe qershíz' e turpshme por sí vashë
Q'í çel sytht' e kuq të saj gjumashë
Sí dhe karamfíl' e trëndafílí
Që pa dashur vjen të fton sícílí.
Po të hyní brènda do të shíhní
Sí ju prêhet syrí nga q' e shtíní:
Në të bardhë muret gjíth të lyer
Sí një trup í paqm' í papërlyer!
Dhomat, posht e rrotull bukur shtruar
Gjíth me shtresa dore zonje shkruar,
Q' u shkëlqejnë ngjyrat qysh ylberí
Me fytyra shkabe dhe sklífterí;
Prej shtëllungash—díta pa u-gdhírë
Tjerur leshť e bardhë, fíje-dlírë,
Sí velenxa, shkorsa dhe qílíme
Endur gjíth me këng' edhe-êndërime;
N' avlímend punuar dit' e natë—

Siç' tek na me zell punojnë gratë;
Ç' do q' u del nga duart e qendisur
Esht gjith lule-e flutura stolisur;
Më ç' do send të vet' e të shtëpisë
Duket dora, mjeshtri-i bukurisë!
Pa le djellit rrezet kur i çohen
Faqe faqe ngjyrat, sheh si ndrohen,
Dhe kur hên' e plottë vjen e bije
Sheh pallate prallash plot magjije;
Ku gjen krejt një pritje miqësore
Si nër viset t'ona malësore,
Tek ju presin – jo më pak bujare
Zonja si dhe vajza shtat-krenare!

Urdhëroni zot, në fshatin t'onë
Që pret dyer hapur si gjithmonë,
Se mundimi kot s' ka për t' ju vajtur
Sa-do, mênt e kini për t'a mbajtur!
Se një drek' e darkë do të gjeni
Dhe një shtrat të mirë ku të fleni;
Dhe tek një të varfër po të shkelni
Pa ju pritur mirë s' do të delni!
Ka sicili – miqtë për t'i prekur
Një lakror e mish a zog të pjekur;
Vez' e petka, gjalp' e kos a shalcë
Po gjith aq të majmë mu si palcë!
Pa le qumësht, djath' e gjiz' e dhallë
Plot, se fshati ka mjaft gjê të gjallë.
Dhen e dhi, si kecër ka dhe shqerra

Lopë-e viçër, dema dhe mëshqerra
Nër kullota çuar me barinjtë
Të shijojnë bàrin e kërthinjtë;
Dal nga dal kur kthehen mbrêma herë
Fyell e këmborë zjejnë n' erë,
Tufa, tufa malit kur se vijnë
Të ze malli kur po blegërijnë
Që t'u-a mjelësh qumështin e majmë,
Siç' tek na q' e kanë, mënt sa mbajmë!

Urdhëroni, zot, në fshatin t'onë
Ku fryn er' e malit si gjithmonë,
Se katundi ynë, fala Zotit
Eshtë plot nga ç' do prodhim të motit:
Grurë ka, dhe mísër e tërshërë,
Pa le vreshtat, zot, kur janë bërë
T' êmbël mjaltë rushtë si ngaherë
Që del syresh fort e shijshmja verë!
Ka edh' arra e qershí e thana
Po nër nè mê shumë bêhen mana
Por sí vêthe varg q' u mvaren sêrët
Gjer sa skuqen, nxíhen në të bêrët,
Që, prej frytit tyre kaq të shquar
Del një-e pirë me-emër të dëgjuar!
Pa ka dhe fasule t' êmbla shumë
Se burímet rjedhín porsí lumë;
Nër luadhe rítet bar me lule
Dhe në kopshte kunguj plot me tule!
Uj' í ftohtë derdhet nëpër kroje

Ujë, q' ep shëndet po pive soje
Që del malit, shket për mes lajthije
Gur mi gur me sulmin êngjërvije.
Pa në kemi bujq e punëtorë
Gjith flori që del ku venë dorë.
Në fshat t'onë burrat nuk përtojnë
Si dikû që gratë t'u lërojnë.
Ca, dhe vatrës tyre në largohen
Gjith për fshatn' e vet' ata mendohen
Nga të gjitha t'jetë plot shtëpija
Siç' e do dhe nderi dhe vetija.
Portën miqve në gjithmon u-a çelim
Se zakonet, zot, në nuk i shkelim,
Se ky Vêndi-i yn' munt ka të metta
Po, për pritje miqsh, i tretet jeta!

BKSH

DURRESI

I

Qytet kujtímesh shekujve të shkuar
Në shkallë madhëríje shpesh q'u-ngríte,
Me ty Qesarí mburej pa pushuar
Dhe Roma plakë prekte rreze dríte.

Shtatuj' e tempuj her'í zbukuruar
Në gjirín t' ênt me nder Shkëlqesa príte,
Dhe zonja zemër-bardha e sy-kulluar
Me valle nër pallatet í zbavíte.

... Sot mí rrënímet e së Bardhës jete
Pa pik mëshíre, fatít í mallkuar
Përdhè sí trup pa frymë-í shtríhr'u trete.

Veç detí, vala-e forcës s'ameshuar
Mí plagët e së ngratës robëríje
Shpesh kêngë-í thur së shkùarës lavdíje.

II

Por fatí nuk të lâ në gjí t' harrímit
T'a prurí çasín - ças í rall në jetë.
Së rísh t'a marrësh rrugën e Kujtímit
Mí ball t'a vësh kurorën e vërtetë!

Dhe dyert krejt e ndryshkura í hape...
U-mhushnë dheu e qjellí prej gëzímit,

Sa prej ç'do ane me të shpejttë çape
U-sulnë sí në fushë të kushtrimít.

Prej gazít, shpírtí qjejsh të fluturonte;
Skëterrën në Parajsë krejt e ndrove,
Në purpër prap u-mveshe sí qëmotí.

Shkreptímí-í drítës sytë t'í verbonte–
Në djell prêndvere zemrën e freskove:
Fatlum ky ças që po t'a falte Zotí!

III

Po kùr-se qjellí dukej mê-í kulluar
Përposh vullkanít zjente pa pík drojë:
Sí zjarrí e í njëj furre së shíluar
Që don të shfryjë dhe të përvëlojë,

Tej kërcëllíme dhêmbësh të tërbuar
Dhe grushte me bërtítje míjrash gojë;
Rrufé përmí dasmorët e gëzuar:
Sa kupat rafsh, u-bínín përmí shtrojë!

Fuqíja s'të ndíhmonte t'u bësh ballë
Se keshe mjaft mëkate për të larë...
Sapô ç'do faj shpërblehet në këtˈ jetë!

Dhe tí me sy pe njˈ êndër krejt të gjallë
U-ngríte gjer në kulme të pa ngarë:
Sa ré greminës krye-tatëpjetë!

IV

As port' e qjellít mírë nuk qé thyer
Për Fronín me kurorë q' ísh gatuar,
Passí një fat-rëfenjës pat dëftyer
Me kêngën-shugurím q' í kísh kushtuar.

Kur, dor' e njëj fuqíje së pa dukur
Një sy í lík sí-í shpëndve të kobímít,
Pa frík' e çorrí purprën ngjyrë-bukur
Q'e mveshe Dhêndrín dítën e Shkëlqímít.

Sí gjahu thonjvet bíshës shpírt-mízore
Sí Krishtín q' e mbërthyen me perona
Kësíj mënyre vojtjesh t' íshte thënë!

Me vaje-u shduk shqíponja dy-krenore!
Por jo dhe bashk me 'të dhe shpresat t'ona
Dhe múndí í-aq dëshmôrëve të rênë!

V

....Prej gjírít të pafundjes së tmeruar
Ku rreze drite rêndë munt të shkasín,
Vet-veten prej mëkatve të shkatruar
Të mundurít e jetës tek e vrasín,

Ashtu dhe tí je, vargjesh í penguar
Sa-as míqtë ndaj kuvêndít nuk të qasín,
Veçsè në varr të zí që t'êsht gatuar
Në ças të parë-atje përmbys të t'kllasín!

Por, êsht një gjyq hyjnor, një gjyq i lartë;
Një sy ç' do send që s'lè pa e dërptuar
As pa-e dënuar shpata-e tij e zjartë,

Një vênd në botë prap të pat kushtuar
Se vojte mjaft mëkatet sa i lave...
Ç'do faj t'a fal, një-zê të thotë: AVE!

1919

BKSH

FJALA E DODONES

Te pylli-í errët í Dodonës vjetër
Një Tempull dore mjeshtrít ísh latuar,
Në botë shoq sí nuk í gjíndej tjetër
N'ërgjënd edh' ar shtatuja rreth qarkuar!

Së largu plot kanísqe víjín mbretër
Me nder tek Príftëresha gojë-uruar,
Me falje-edh' agjërime sí ca-ashketër
Jasht prísjín fatn' e vet për t'a dëgjuar!

Por fatí-í s' ardhmes syt' n'í ka të lídhur
E ndron shpesh rugën shortí q'e ka gjojtur,
Veç me një fjalë, qiellít síkur thënë!..

Sa frone s' u-përmbysnë duk' u-drídhur
Dhe krerë popujsh, mënç sa s'kanë lojtur:
Se Plakës fjalën 'rè s'í-a patnë vënë!...

BKSH

APOLLONIA

Rrëníme trishênjta të kohës së shkuar
Që sot kryenaltë zbuloní një jetë,
Një jetë me famë shkëlqímí të shuar
Gjíth botës q'í ndrítí një rreze e vërtetë.

Nga gjíret e tokës arbnore ju shkundní
Çudírat e mëndjes, díkur e pashoqtë,
Pas shekujsh prej gjumít ju natën e mundní
Të shihní ndryshíme që kurrë s'í poqtë.

E ndjejmë, rrëníme hyjnore, ç' tregoní
Në gërmat e gurrít të gjírít që hapní,
Sa ngjarje nër vepra krenare na thoní :
Kujtíme luftímesh me mburje q' í kapní !...

Qytét í-Apollonít, qytet madhështíje
Pasqyrë dhe shêmbëll për sá që të díjnë,
Nër kombe të fortë shëndríse lavdíje
Sa sot prej së largu mí trollín t'ênd víjnë.

Stërgjyshrít e hershëm nër muret e tua
Çvíllonín pushtetín e díjes së tyre,
Sadoqë në gjuhë të marrë sí hua
Por díjnín e jepnín shkëlqím ç'do fytyre.

Tek ty díjetarët këshílla shpërndanín
Me gjurma të gjalla të një qytetrimí,

Shkëndija përhapnin—sa trutë q'u mbanin—
Të parë që dilnin në fushë mendimi!

Në Romë Senati ndaj teje-e kish synë;
Qesarët të prùrnë mbretnore dhurata,
Mi qerre triumfi nër tempuj të hynë
Stolisur dafinash, me nder edh' urata.

Mi detin e kaltërt anija lëvrijin
Të shpijen në botë ç' do send mjeshtërije,
Shtegtarë të pasur gjith vejin e vijin:
Tërhequr ndaj teje si vênd mrekullije.

Ushtarë bij trimash për ty falnë jetë
Dhe mbretër të thurnë lavdi dhe kurorë,
Mendarë nër libra mësimesh të mprehtë:
Të ngritnë në kulme që s'preken me dorë.

Me ty sot po hapet, prej hirit zbuluar
Një faqe e rè historije bujare,
Të Kombit që rojti dhe rron papushuar
Nër brezat e sotmë mi tokën shqiptare!

Pellasgë-e Illirë, si Grekë-e Romanë
Prej brumit të tyre paslindi një botë,
Dhe veprat pa vdekje, thesaret që lanë:
Si shëmbëll t'i mbajmë si nderi-yn' e thotë!

HYMNI I FESTES

Fest' e kuqe, fest' e bukur
M' í lumt' dora kujt të bëri
Send í rallë më je dukur
E dhuratë Perëndije,
Sa fuqinë s' ma ka zêrí
Për të t' thurur hymn lavdije.

Sa të dua fest' e kuqe
Vetëm shpírtí munt t'a thotë
Kur mí kryet sí burbuqe
E çel ngjyrën prush të gjallë
Zemrën un' e ndjej të ftohtë
Trut në kok' í kam vërdallë.

Mij çudíra tí ke bêrë
Me ndryshímet e pa masë
Q' í ke prurë botës têrë;
Sí me shenjë magjístarí
Tí ç'do goj' e zij mos flasë
S' lij të dalë kush í parí.

Por sot hije t' u bê nderí
S' të peshojnë bota fare
Mbete rrugës qysh í mjerí
Q' í përunjet ç' do kanuní,
Se kjo toka n' ê' shqíptare
S' êsht mê çerdhe-e ç' do majmuní.

Sa shqíptarë ty s' të falen
Me gjíth shpretkë s' t' adhurojnë
Kur të shohin vëndít ndalen
Prej magjísë q' u ke shtënë
Sa dhe lotet u píkojnë
Aq' në zemërt u ke rënë.

Pa ty janë të sëmurë
As në gjumë s' të harojnë
U djek zemra por sí furrë
Për ty feste fat-mízore !
Se sa-pô që të vështrojnë
Drítën syve krejt u-a more.

Nër të huaj kur shetítin
Mos të duken sí „të vjetër"
Shpesh kapella kryes ngjítin.
Por tí feste mos rí dehur
S' t' a mer vëndín as kush tjetër:
Se ndë gjí të mbajnë fshehur.

Jashtë bota s' í kuptojnë
Turq në jan' apo shqíptarë;
Sa-do festet që t' í ndrojnë
Zemrën písë prap' e kanë;
Se në duken sí „të larë"
Në shpírt janë turkomanë.

Sot dísa të përparuar
S' dí pse ngjyrën krejt t' a ndruan,

Prej së kuqes së bekuar
Tërë jetën që s' u-ndanë
Në të zí të pagëzuan:
Majët thyer në dy anë!

Prej së huajsh kurse kthehen
Qofshín me a pa mësíme
E të mënçëm në pandehen—
Dhe sadô që mírësjellës
Víjnë prap' n' ato qëllíme:
Presín strehet reth kapellës!

Roben, qímen kot e ndrojnë
Qoft' minístrat, deputetët
Kur për Kombín bísedojnë
Plot me „ndjenja shqíptarije"
S' í nxê froní krejt të shkretët:
Pa ty, korbe, s' u ka híje!

Por ty feste né s' të qajmë
Tín' e ke folenë t'ënde!
Por mëkatet sot q'í lajmë
S'u-mbaruan gjer më píkë
Se sí gjyrmë në kta vënde:
Le, shqíptarët fanatíkë....

1922

VLORES

Vlorë, Vlorë, zall e det
Hyll prej qiellit je pikuar
Dorës Zotit e gatuar
Si rall shoqe ke mi dhét.
Vlorë-e bukur, lumja ti!
Dita, nata sy-kulluar,
Ver' e dimër lule-shtruar
Je si nuse plot stoli.

Ti je balli me florinj
Ti je lulja-e Shqipërisë,
Dhe trumbeta e Lirisë
Pleq që ngjalle dhe të rinj.
Tërë kombi të sjell nder
Me lavd emrin t'a ka shkruar
Se ti trime vet' me duar
Fijt' e Flàmurit ke tjer!

Je kurora me shkëlqim
Gurrë shtrenjt, margaritarë
Që dó mjeshtër magjistarë
T'i radhuan me qëllim.
Zjar lëshojnë që verbon
Si hyj rotull të shëndrisin,
Rreze ngjyrash llambarisin;
Për sy bërë që lakmon!...

BKSH

Mí tre skajet lagur det
Një, rip malesh, tjatër fushë,
Në mest ishul sí një gushë;
Tí për ball' u rí sí mbret!
Reth pëqinjtë thurur ar
Me plot dorë Perëndije;
Vlorë çerdhe trimërije
Mburje-e kombit e thesar.

Gjirit t'ênd, gjí madhështor
Detí-í kaltërt í pshtet kryet,
I ndeh buzët, epet, thyet
E të puth sí një dashtnor.
Djellí lint a perëndon
Rrezet lozín míj' fytyra,
Natën qíellí sí pasqyra
Nga kandílet ar píkon!

Kur jasht teje fryn, gjëmon
Shkumbë-e valë ngreh përpjetë,
Píkë-ërgjëndi rahín rehtë;
Një tmer lufte që s'pushon,
Zana-e detít mê s' këndon
Rí dettarí mëndje shkretë,
Copra-anijesh ngasín vetë
Shoqí shokun q'e kërkon.

Por tí dyert sa q'í hap
Je parajsí-í êndëruar,

Q'i falë prêhjen e kërkuar
Ç' do kujt gjíret që t' í kap;
Tí je tempulli hyjnor
Lundërthyerí ku ndalet,
Sí njëj kore vjen e falet;
Kêngë lutjesh ku përdor.

Të vu Zotí n' atë brí
Që t' jesh roj' e-Adríatíkut,
T'í mbash shtegun ç' do armíkut
Çveshur kordhën për lírí!
T' a tundsh krahun me kuxím
Fatí barrën t' a pat dhënë,
Për t' a mprojtur nderín t'ênë
Derdhe gjakun në kushtrím.

Rrotull fqínjët sa fuqí
Sa mënyra nuk përdorín,
Me pahír që të t' a korrín
Ç' do send, Vlorë, mban në gjí!
Mund e bíj ke pas armíq
Me syt' katër gjíth pas arít—
Jasht zakonít të Shqíptarít;
Që s'shet besën për ca fíq.

Por tí Vlorë mos u-dro!
Mbaj mburonjën me qíndresë
Se kush vetes í zë besë
E mat grushtín me këdo.

Se dhe Deti-mik kur flè
N' êndrat kryen një dëshirë:
Mbret të jet' e Zot i lirë
Veç për Tokën q'i dha bé!

1920

Bksh

MARSHI I DJALERISE SHQIPTARE

Gjithmon përpara Djalëri
Për nderin t' ênd, për Shqipëri.
Gjithmon përpara për liri
Për Mbretin t'ênd, për Shqipëri!

I

Djem ejani me vrap të parë
O bijt' e Kombit t'onë mbarë,
Nër male-e fusha gjer në det
Një zê-ringjallje na thërret:
Gjithmon gati, gjithmon përpara
Tek shtrihet toka jon' e fara,
Me kêngë nëna ku na rit
Ku zogu bêhet një petrit.

II

Gjith ju të rrugës arratije
Me zemrën djegur prej mërzije,
N' i doni vehtes një shpëtim
Me nè së bashku pa vonim.
Se rruga jonë s' ka të mettë
Na qet në dritë të vërtetë
Nj' aty ku qjelli që shkëlqen
Prêndvera,-agimi që dëfren.

III

Virtutn' e brezave të shkuar
Dhe famën trimash të dëgjuar,

Që flenë kêmba ku na shkel
Në shpírt t' í kemí për themel;
Kurorën sot q' e kemí vênë
Për 'tê sa burra s' kanë rênë
Q' e bênë vehten shënjt alltar:
Që trashëgojmë gjak bujar!

IV

Sí shkabat çerdhen q' e qëllojnë
Me sy dërptonjës që t' a mprojnë,
Nj' ashtu këtë të dashur vênd
Gjithmon t' a kemí në kuvênd;
Ç' do mall t' í-a ndjejm' e ç' do dëshirë
Plot zell e plot vullnèt të lirë,
Se fjal' e besë kush nderon:
Djem, Perëndija e bekon!

BKSH

TE RINJVE

O ju, që vijní paskëtaj plot shpresë
Sí-atà që s' dinë çase psherëtimí,
Që s' panë vojtje-e as durim mërgimí
As zemrave pik helmí që t' u zbresë.

Na, rrugën drejt e mbajtmë gjith me ndjesë
Të tretur shumë herë nga trishtimí;
Por mjaltë krejt na dukej hidhërimí
Kur shihním se fjala jonë se ze besë!

Por nà, ju lemë, shkojmë sí shkon vesa —
As gjê mbí dhé s' qëndron për gjithëmonë;
Sí trashëgim ju lemë shpírtin t' onë!

Né shkojm' o shokë—po s'na shuhet shpresa
Se fjalën që ju lamë sí pasqyrë
Gjíthmonë do t' a kení shëmbëlltyrë!

BPSK

— Djem o trima, burra lufte
Mos m' a patë djalin vallë,
Çun sokol e trim me fletë
Pamje-çelur e sy-gjallë ?
Shtat të naltë, burrë mali
Trëndafilë m' i kish faqet,
Vjet njëzèt pothuaj kishte
Dhe pa dirsur as mustaqet.
Buz' e tija gjith me kêngë
Në brezt fyell lule-shkruar,
Më të qarë kur i-a merte
Kodrat ishin duk' ushtuar.
Malli-i tija qenë malet
Dhe mburimet uj' êrgjëndi,
Shtrat i tija qenë bjeshkat
Shokë, lulet e ç' do kêndi.
Kur prëndvera hapte fletët—
Se prëndverë që dhe vetë,
S' linte skaj pa mos e shkelur
Posht' e lart si shpes' e lehtë.
Për dëshirën e Lirisë
Që kur vêndi zu të shkelet,
Në të parin zê kushtrimi,
Nisi ênda që t' i çelet.
Për lirin' e vatrës shênjtë
Ku që lerë, ku që ritur,
Për vëllezër ndënë thundër

Mêndja djalít í qè ngrítur!...
Me ju bashk' u-nís or burra
Me ju shkoj që të luftonte,
S' kíshte prêhje s' kíshtë gjumë:
Shqípërínë gjíth kujtonte.
Me fustanen por sí dhêndër
Dhe me gunën supít shtënë,
Pushk' e tíja sí një nuse;
Dhe një flâmur në gjít vênë.
As më thoní, bíj, o çuna,
Në më rron a po ka vdekur,
Se prej mallít tíj po tretem;
Se për 'tê në prush jam pjekur.
Veç atë kam prej sa patshë
Djalë-zogë, sí pëllumbí,
Me thëríme vet' e ríta
Që kur t' atn' e hêngrí plumbí;
Kísha burrë sí desh Zotí
Burrë trím e zemër-mírë.
Me nder rojtí sa që gjallë
Po pat fundín të vështírë:
S' dí qysh delja pat shpëtuar
Në një luath për kullotë,
Kur shkoj murgu që t' a zêrë
U dërgua tej n' at' botë!
Jemí bujq e truall s' kemí
Zotërínjt' e mbajnë frerín,
Prej lëmoshës tyre rrojmë:
Nè me lott' atà me nderín.

As shtëpija s' ësht' e jona
Kur u k'ênda jasht na qesín,
Për një dru në vatrat t'ona
Me të rahur shpesh na vdesín.
Me se rojtke, s' hapín fjalë—
Nga të vetsh, o bir, kur s' di nga,
Po një jetë plot mungesa
Kur pa buk' e kur pa-opínga.
Gjith sí kokra vese dírsat
Nëpër faqet na kullojnë,
Têrë dítën shpínë-thyer
Punë, punë na kërkojnë.
Në ç' do brazdë të parmêndës
Djersa jonë ka píkuar,
Nga sa korrím një grusht s' kemí :
Veç me nejet nëpër duar !...
Qysh jep zogut dëllëndyshja
N' goj' ushqímin kur í-a bíje,
Un' ashtuth e rita djalín
Kur në djell' e kur në híje.
Të mbjell n' arët a të kornja
A me shatën për në vreshtë,
Djalín pas gjíthmon e mbanja
Kryever' e gjer në vjeshtë.
Pres e mjera, pres e shkreta
Të më víjë t' í puth ballín,
Se jam plakë dítë-shkurtër :
Dua zemrës t' í-a nxjer mallín.
Mu ndë syt' e tij të kaltërt

Dhe mí flokët sí kallírí,
T' í ve buzët, t' í ve duart
T' í-a pshtet kryet drejt te gjírí.
Të më vínte t' a martonja
Me një nuse vajzë tríme,
Dhe kurorët t' í-a u puthnja
T'a gëzonja jetën t'íme.
Kur erth díta q' u-nda meje
Arth më puthí balí' e dorë
Më zu qafës me mall bírí:
Dhe më lâ kështu të gjorë.
Lot të nxehta sysh më bíjnín
M' u-droth trupí, më ra píka
Kur tha: „mëmë lamtumírë"
Sa mes zemrës shkojín thíka
T' jesh e vè sa pun' e keqe
As një ndíhmë prej gjëkundí
Gjíth me djersë për një bukë;
Po kjo shpresën nuk m'a tundí,
Pata dít' e nete vojtjesh—
Fatí-í keq kur t' a ve tmerrín,
S' më díl mêndjes mallí-í tíja
Sa kujtímet sot më therrín.
Ec' í thosha n'Amerikë,
Vênd ku lozín me dollarë,
A tekdò, të rosh fatbardhë:
Jo me dhen e me gomarë!
Fjalët s' doj të m' í dëgjojë:
— „Një dëtyrë kam moj mêmë

S' më le zemra, tha, të huajt
„Që t' a bêjn' atdhenë lêmë.
Porsi korbët mi stërvinë
„Po na çqyejn' copë copë
Vênd për varr mê mós na lenë:
„Të na mjelin si një lopë.
E ndjej turp kur jam në moshë
„Mos t'a bëj dëtyrën t'ime
Ç' vlerë kanë ca të holla
„Nder po s' pate sa një qime.
Sa nga t' anët s' kanë shkuar
„Nëpër botë s' kanë mbetur,
Dhe n' u-mbushnë me thesare:
„Me 'tâ bashkë janë tretur.
M' i ri n'është vjen martohet
„Rri me gruan dy-tre muaj,
Pastaj ikën edh' harrohet....
„Gjen të tjera nër të huaj.
Sa të reja s' kanë qarë
„Prit e prit më kot një jetë,
Dhe sa mêma s' janë tretur
„Duke mbetur fílli vetë!
Nonjë syresh e në kthehet—
„Mall në pastë për atdhenë
S' e nxê vêndi, qysh i huaj
„S'i gjen shije, syt' s' i flenë.
Shumë syresh me fëmijët
„Rritur mirë, bërë njerës,
Por ç' dobi për Shqipërinë

„Kur í rínë lark së mjerës.
S' e mban mênt díkur më thoshe
„Yt-vëlla sí mê s' pat erdhur :
Kíshte pasje, dhe në kíshte :
„Për ty gjê, ay s' pat derdhur.
Në ka burra dhe të zotët
„Që ndíhmuan pa u-lodhur
Emrí-í tyre gjíth përmêndet
„Më ç'do vênd që janë ndodhur.
Po, më k'ênda të rroj jashtë
„Në të mbathur í límuar,
Por s' le vêndín e në mbajtsha
„Dhe nj'opíngë të pa-kruar.
Po s' punove qysh dí vetë
„S' ke nevojë mê të qash për
Do të tjerë që po thonë :
„Tek na jeta qênk' e ashpër.
Se sa eshtrat të më kalben
„Lark katundít t' em q' u-ríta,
M' í kënaqur jam me vdekje
„Për Atdhenë nëpër príta !"
Ju e pattë se qysh ndízej
Sytë flakë sí-í lëshonín,
Kur erth ora që të shkonte
Plot gas buzët í-ndríçonín.
— Vafsh shëndosh' o djal' í mbarë
Me bekíme nga-ana íme,
Puna jote daltë mbarë ;
Mêma jote bên uríme.

S' më vjen, bir, të ndahem teje
S' i-a di dítët pleqërisë,
Po, luân u-kthefsh, i thashë,
Ti je shtylla e shtëpisë !"
Po më duket se s' kam shpresë
Endra tmerri siç' kam parë;
Si-kur qitnja një dhëmpallë;
E nj' e keqe mos ka ngjarë.
Me shtëllungën të tjerr leshtë
Pranë vatrës kur se rinja,
Gjê kërciste nëpër dhomë;
Mirë s' ish, nga pleqt' e dinja.
Sa her' isha në mejtíme
Syr' i mêngjër më loj dëndur,
Se s' qè mirë, këtˈ e dinja
Dhe shpesh qanja si një-e çmêndur.
Dhe në shpatull kam kërkuar—
Kur një qengj e pata therrur
Po kur pashë fatn' e shkretë
Mênt e sy më janë t' errur:
Për së largu rè të trasha
Pellgje gjaku skuqnín tokën,
Tym e flakë, varr të hapur
Un' e zeza humba kokën.
S' di në luftë në ka rênë
S' di me nder në ka luftuar,
Mos armiqvet u-êshtë dhênë
Mos gjêkundí êsht harruar.
Sa për nder të Shqipërisë

Në râ djalí „falur qoftë".
Se nga zemra s' thom të keqen;
Shqipëríja veç-se rroftë!

—Rríj e qettë, mos qaj motrë
Mbaj-e zemrën bënu burrë,
Se yt-bír e lumur mêmë
E në vdíq, ay s' vdes kurrë.
Se t'atíllë burra s' vdesín
Gjaku-í tyre bêhet vesë,
Q' í çel lulet e Lirísë
Dhe për Kombín janë Besë.
Vet' e pamë qysh luftonte
Sí luân mí mal përpjetë,
Pushk' e tíj çudíra bênte:
Bíj armíku mu sí fletë.
Më ç' do msyjtje që í parí
Gjíth me kêngë-e zínte trapín.
Ku kërcíste pushka rêndë
Ish ay q' e merte vrapín.
Mbrêma herë rrotull zjarít
Kur po mereshím me fjalë,
Rríj me vesh duke përgjuar
Kokë *bufi* mos na dalë.
Dhe kur deshër nè po rípním
Nër hej prushít duk' í pjekur,
Doj ç' do punë vet' t' a bênte
Sí-kur íshte dorë-hekur.

Mírr vërcakun síç' po dínte
Coprat míshí vet' í ndante,
S' línte shok pa e kënaqur;
Sa për vehten kokë s' çante.
Pleq e plaka prej ç' do fshatí
Kur na síllnín për të ngrênë,
Ish í fundít që gjíth príste
Pakëz gjellë për t'í dhênë.
Keq na vínte kur e shíhním
Se kujdesej aqë shumë,
Sí një plak gjíthmon na thoshte:
—„Të gjíth jemí sot një brumë!
Për dít' mêma më kujtonte
„T'a kem zemrën, thosh gjíth hapur
As zílía vênd mos ketë
„Në shpírt t'em për t' u-përhapur.
Gjíth sa pragun që na shkelnín
„Qysh të huaj dhe fshatarë,
Me ç' na ndodhej í nderoním
„Sí do míq qëmotí parë!"
Kísh një gojë t' êmbël mjaltë,
Kur, do sende na tregonte,
Prej njëj gjyshít tíj dëgjuar;
Sí pas çasít q'í kujtonte.
Fjal' e tíja na pëlqente—
Se kísh bíndje, mírë-rítje;
I kísh ênda qysh njëj plakut
Të na thotë pa mërzítje:
„Se qëmotí gjyshrít t' anë

„Qysh sot s' íshín të përçarë,
Një fè kíshín e një ndjesë
„Me qëllíme të pandarë.
Por kot mûnd-í tyre vajtí
„Ardhë dítë të këqíja,
Mjegull dhen' e pat mbuluar ;
„U dërmua krejt shtëpíja.
Atrít t' anë síkur s' íshín
„Bíjt' e tyre, bíj një fare,
Sí të verbër njëri jatrín
„Nuk e njíhnín ; t' egër fare.
Për të huajt u-coptuam
„Dhe ne mbetmë varfanjakë,
Të këputur dhe të mjerë
„As një dorë s' na ndíh pakë.
Mírë botës që t' í bêjmë
„Fat í tíllë na që shkruar,
Sot të mirën t' a shpërblejnë :
„Syt' e zemrën me t' í çpuar.
Dhe ky flamur yn' í vyer
„Para kohe ka valuar,
Por të sotshmít as që dínë
„Se ç' gjê patnë trashëguar.
Shíh dhe sot sí djepet t' anë
„I skuq flâmurí-í uruar,
Sí dhe n' arkat e martesës
„Të dy shkabat janë shkruar.
Sí një korë le t' a kemí
„Se na jep kuxím e shpresë,

Dhe kandíle ne t'í ndezím;
„Dhe për 'tê kushdo të vdesë.
Sot armíqtë me ne tallen—
„Mê të zínj se bíj skëterre,
Nëpër baltë na e ndyjnë
„Më bísht qení sí levere!"
Sí këtò dhe dô të tjera
Na tregonte nër pushíme
Gjer sa nj' urdhër dhe më kêmbë:
Kísh arth ora për luftíme.
Se ç' do kêndít Shqípërísë
Kêmbë-armíqt' í kíshín vênë,
Djatht' e mêngjër nga-do vínje
Mí ne syn' e kíshín shtênë.
Pa mëshírë të na shtypín
Me një luftë që të therrte,
Por sí qenat nga një copë;
Mê të madhen kush t' a merrte!
Sul-u lart e sul-u poshtë
Ne s' í-u trembëm as të fortít,
Kur u-hothmë me gjíth zemër
Mê s' í-a ndjetím frikën mortít.
Për ne lufta që një dasmë
Barra sendesh mjaft na ranë,
Ball' í bêmë ç'do rrezíkut:
Mjer' armíqve syt ç' u panë.
Dhe kur Vlorës í-u afruam
Reth me tela gjêmba-gjêmba
Më zê thírrí: „Djem përpara

Djem në kíní gjak në rrêmba!“
Dhe mer sulmín trimí-í rallë—
Se në hovet í kísh ênda,
E shtron gunën ne pas tíja:
Dhe matanë të gjíth brënda.
Tej nga detí porsí breshër
Poplat zjarrí hekur-rrumbull,
Të mallkuarat na korrnín
Kur që sipër bíjín grumbull.
Ne përpara gjíth po príjím
Kíshím shênja, bêrë fjalë,
Nonjë-e keqe mos na ngjasë
Me syt katër, me nga dalë!
Por ay na tha: „Përpara
„Burrat s' dínë ç'ësht dëshprímí,
Puna jon' êsht pun' e shênjtë
„Dhe ky flâmur êsht qëllímí.
Be mí flâmur, djem, betuam
„Se ne brënda do t' a ngulím,
S' jemí burra po t' a shkelím:
„Jasht' armíkun do t' a çkulím.
Një pëllêmbë vênd na mbetí
„Prej kaq toke së bekuar,
Se stërgjyshrít kur luftonín:
„Gjíth të tjerë gjenín shtruar.
Ne, na marrín për kusarë
„Síkur s' dínë ç' farë jemí,
Se sa burra janë tretur
„Dhe për 'ta sí fqíj q' í kemí.

Për të huaj mirëpritës
„I shqiptarit êsht zakoni,
Po kur sheh se del një gjarpër :
„Shpejt i merret mikut froni.
Ne s'u ramë pa pandehur
„Fjal' u bêmë që të dinë,
Se me miq për të rëmbyer
„S' munt t' a lemë nè shtëpinë.
Por ata në fjalët t' ona
„Vesh e peshë kurrë s' vinin
Tetëkêmbës qenë shtrijtur :
„Dhe me thithat gjak na pinin !"
Prij me flâmurin q'e kishte
Në gjit vênë si një korë,
Syrin soje nuk e hiqte :
Pushka-lule gjith në dorë.
Tej armiqtë sa na panë
Me gjith armët u-hutuan,
Aq shqiptari të jet' i zoti
Kurrë, besa s' e besuan.
Nga gjith anët pushka binte
Në vesht plumbat vërshëllenin.
Nè mi gunat, trupin xvarë
Shkuam telat si s' pandehnin.
Kur u-poqmë ballafaqe
U râ pika, mënt u-vranë,
Falje, falje ! po bërtisnin :
Ngritnë duart edh' u-dhanë.
Kushedi se sa nuk ishim

Një grusht veta, po mê tepër
Ish dëshira jon' e zjartë:
Që Vullneti kryevepër.
Qysh ata në s'patëm armë
As të luftës rregullime,
Por një zemër e ca plumba
Me pak buk' e pak ushqime.
N' aqë gjêmë, luftë tmerri
Nuk luftonte pushk' e shkretë,
Po qe shpirti-i gjall' i Kombit:
Shqipëria dora-vetë.
Prín me flàmur del nga shokët:
„Përmi Vlorë të valojë
Le t'a ngulím, tha, për jetë
„Toka, deti sa të rrojë.
Tok' e Shkabës Dy-krenore
„Me gjak t'ên' êsht pagëzuar,
Dhe ky flâmur, faqebardhë
„Ka gjithmon për të valuar!"
Lart fortesës vate-e ngulí
Po përtej një plumb i shkretë,
Arth në zemër e godití:
Më vênd râ, sí trím me fletë.
Në s'e díním se kush íshte
I gjyrmoním veç qëllímin,
Ish luftar munt i panjohur:
Por sot Kombí e njeh trímin,
E dha shpírtín i kënaqur
Se dëtyrën pat mbaruar,

Se sot flâmurí-yn' í shênjtë
Po tregon kush pat luftuar.
Për nj' atdhe râ, për lëvdatë
Për atë trímoshen Vlorë,
Râ me nder sí bíjen burrat:
Râ me Flâmurín në dorë!

1920

BKSH

LUFTARI LYPES

Lëftova për atdhè
Lëftova për lirí,
Por veshín, një s' m' a ve
As dorë s' m' ep njerí !

Pa kúrrnjë ndihmë jam
Me plagë plot në trup,
Fuqí më t' ecëj s' kam
As robë s' kam mí sup.

Kudô që kam trokít
Një derë nuk m' u hap,
Rrí jashtë prít e prít :
Një copë buke s' kap.

Armíkut s' í jam tut
Në ballët í kam dal,
Shpesh dërmën í-a kam fut
Dhe hóvín í-a kam ndal.

Nër nete qjell pa hyj,
Shtërgata víj me shí,
Vênd s' keshe ku të hyj :
S' dí vetë qysh jam gdhí.

U-treta për dísà
Q' as njíhjín komb, atdhè,

Mbí frone sot atà
Që shgryhen pa një frè.

Me mburje posht' e lart
Bërtasín me një zê,
Se hyjtín mu ndë zjart—
Kur zjarrí s' íshte mê !

Kur ísha në kushtrím
Me shokët për atdhé,
Ata gjíthmon pengím :
C' do çap na venín 'rè.

Kur që nonjë rrezík
Dísà që rrínín lark,
Sot rendín vrík-e-vrík :
S' mendohen veç për bark.

Të tjerë mê shpírt-líq
Që prap na kanë vrâ,
Sot bêhen míq për líq :
Síkùr mê s' jan' atâ.

Mundímet, kush, s' í njeh
Rrezíkun kush s' e pâ,
Tekdó të ngopur sheh
Q' as vunë kurrnjë krah.

S' pyesín sot kush je
S' kujdesen se sí rron,

Kur shkon, kurrkûsh s'të njeh :
Sy-shtrembër të qëllon !

Fëmijët mos mê keq
Të çveshur un'í kam,
Të zit' t'ullirít heq
Nër mênt' e mija s'jam.

Përjashta pa shtëpí
Po breth andej këtej,
Të lyp sí faqe-zí
Fëmijët që t'ushqej.

Një send veç më ngushllon
Dëtyrën se kam la,
Kjo helmet m'í shëron
Pa, fatí-í em m'u pâ.

Një shpresë tek Tynzot
Kam shpírtín që t'í-a jap,
T'a shuaj krejt ç'do lot :
Mos heth mê sytë prap !

1922

VDEKJA E BYRON-IT

Ish muaj prëndvere me djellë dhe kêngë
Si fushat e gjelbra dhe kopshtet verore
Me lulet përveshur në gjire dhe mêngë
Po ndritnin prej vesës pasqyrës qjellore.

I shtríhur mí shtratín e vojtjes Byroní
Me trupín dëshmorí të tretur mendímesh,
I qetë po príste t'a ngrente Kharoní
Të mbyllte një jetë të tmertë kujtímesh.

Kujtíme të tmertë njëj êndjes qyqare
T'í shíhte të gjalla, sa shíhte nër pralla,
Pa dítur se gjente një mushkë xanxare
Në gozhdë q'í hasí koburja dhe palla.

I rítur stërhollë nër botë magjíje
Nër êndra shkrímtarí që dígjej dëshírash
Të dala prej zemre që zjente mërzíje
Për emër dhe famë kur ngjeshet së mírash.

Sí shkabë-e mërguar prej kulmesh eprore
Prej çerdhe së naltë gjíríje bujare,
Në peshë s'e vurí një jetë gazmore
Të mveshur në purpër shkëlqímesh letrare.

Për kombín që vojtí mundíme pa numur
Dhe pasjen q'e derdhí pa humbur vullnesë,

Dha shpírtín sí qyqe në trollín e „lumur"
Me krerë të çartun në ndjenja dhe besë.

Ish dítë prëndvere kur frymën e falí
Sí burrë pa drojë me shpírt të devotshëm,
Síkundër í-a donte dëshíra, ídealí:
Lírínë t'í prurë njëj kombí të motshëm !...

Një lot Mesollongjít, s' í-a lagu qívurín
Prej drrasash me gdhênj sí të fundít ushtarí;
Sí zemrën í-a çorrí, í-a hêngrí dhe grurín
Von, lotesh pendímí, zu tretej së qarí!

Veç qjellí shí lotesh me krísma shkreptímash
N' at' orë fatkeqe shbërthente pa-rreshtur,
Shí lotesh që derdhej nga míjra sy trímash
Në fushë të nderít të rênë zê-heshtur,

Fatlùm o Lord Byron! me ndjenjat e larta
Me vdekjen tí prure nër vise të shkreta
Lírí-Perëndeshën me rreze të zjarta
Që shpallet e ndrítshme Jot-Vepër sa Jeta!

PYRRHUS ET CINÉAS
(Burri edhe Qinea)
— Nga frëngjishtja —

Përse aq' elefantë, aq' armë-e aqë sende,
Edhe aq' aníje plot, për t' í lënë kta vende?
I thoshte Burrít mbret një í-urtë besëtar
Këshilltar fort me mënt í njëj mbretít mburtar.
— Po vete, mbretí-í tha, në Romë tek dua-unë
— Ç'të bësh?—T' a qerthulloj.—E bukur fort kjo punë
Q' í ka veç Lekës Math híje qysh edhe ty;
Po Romën massí-e mer, Zotní ku shtije sy?
— Sa për Latinët tjerë-ësht punë fort e lehtë!
— Po ze besë q' í mund; fundí pra ky do t' jetë?
— Síqílja n' a ndeh krahtë, e pa mundím pastaj
Syrakusa anijt' í ka në gjí të saj.
— Do qendroní aty?— Po na râ-ajo në duar
Një er' e mbarë nesh pas Kartagjína-ësht pushtuar.
Tër' udhët janë çel: pastaj kush na mban dot?
— Ju mar vesh, Zotëní, puna s'na vete kot:
Me t'í shkuar me hír rrêrët zemë Líbiën,
E shkelím me një vrap Egjyptën, Arabiën,
Vemí Gangut përtej, nënëkêmbím ç'do vís,
Sqythía ka m' u dríth gjer tej në Tanaís,
Ligja vemë të ra në tërë këto tokë,
Po për t' u-kthyer prap vall' ç'u shkon nëpër kokë?
— Oh, í dashur Qinè, plot gas e knaqësí,
Mundím me plot dëfrím të rojmë në lumní!
— E, Zotëní, dhe sot pa dalur Shqipërisë

Që kur gdhín gjer sa ngrys, këtu pranë shtëpisë
Kush vallë nè na ndal të qeshím sí na vjen
Kohën t'a shkojm' ashtu sí neve na pëlqen?
Këshílla qè me mënt, lehtë për t'a shíjuar
Burrí-í lumtur do t' ísh po t'a kísh dëgjuar!

BKSH

VALLJA E JETES

BKSH

BKSH

ORA E ZEMRES

Shkríhen ujrat nër líqene
Qjellí fletët nís í hap,
Mbyllur zemra rrí sí qene
S'do të çohet jasht një çap.
Strehve treten dhe krongjíjtë
Shterrín lotet gjíth pík pík,
Zemra hesht e mbleth pëqíjtë;
Me një sy, më sheh, të lík.
Maje bískut zogu tundet
Rreze vere gjíth po pret,
Gjumít zemra s' dô t' í shkundet;
As një ndjenj' asaj s' í flet.
Kryet kaçja qet sí tríme
Plafn' e bardh' e flaku tej;
Tuf' e barít, djè sí qíme
Sot çel gíshtrat mu sí hej.
Dhe gjínkalla mer qítharën—
Nj'arratítës vjershëtor,
Rrí mpreh zêrín mí të parën
Fíje barít prêndveror.
Hap-u zemrë, vjen prêndvera
Rreze shkasín më ç'do skâj,
Mer lahutën díl tek dera:
Nís-í-a kêngës e mos qaj.
Thur-í-a kêngës dhempshurije
Çel-e zêrín magjíplot,
Lígjëratën dashurije

Q'e dha Qjelli dorëplot.
Çohu zemrë, shterr-i lotet
Bjerr-i tingllit ledhatar,
Se gjêsendi s'vlejnë motet.
Sa vlen çasti magjistar!

BKSH

EXCELSIOR!

LASGUSH PORADECIT

Sa herë s'jam menduar krejt pêndën që t'a thyej
Mê mos e mar në dorë, në lot mê mos e ngjyej,
Dhe mallit t'em të shkretë, vênd lark t'i bêj të vejë
Si prej njëj hijes keqe të fshehem mos më gjejë.
Tej dua t'a heth pêndën, llahuta zê mos nxjerë
Dhe kênga-e mallëngjimit në shpirt helm mê mos shtjerë!
Sa herë s'dua lotet mos rjedhin pika pika
Me faqet t'jem të njoma; me gjak si njomet thika
Kur shkon për mezit zemrës si shkon përtej rrufeja
Që nxjer gjith zjar e flakë kur ndahet, del nga reja.
Të mirnja botën vetë, t'a gjeja qetësinë
Nër êndra lumërije, t'a shijoj vetëminë,
Si në liman shpëtimi anija ku gjen lirinë
Nga valat mê mos tundet, të ketë sigurinë!

. . . . . .

Por jo e shkreta zemrë! Sadó që po mundohem
T'i mbush atô dëshirat që jam duk' i kërkuar
Të jem gjithmon' i lumur me shpirtin e qetuar,
Nga hekurat e rênda të dal e të çlirohem
Nga muret burgu thellë ku dergjem e coptohem,
Porsi luâni leqesh që pret një ças shpëtimi
Lirinë t'a fitojë, të shfrejë nga mundimi,
Edh' un' atê po doja me vrullën fluturimi
Të marr tej arratinë, tej doja të largohem
Atje ku ndjej dëshirë dhe lark e lark të çohem
Nër vënde të pa-parë, nër qjej mê të kulluar

Ku kêmbë mëkatare s'pat shkelur as qëndruar.
Atje të jeshe doja në botë lumërije
Ku dhembjet e zemrimet vënd s' kanë-as u ka hije,
Ku s' ndjehet grushti-i fatit me gjurmat tij mizore
Që shembën aq vullnete dhe aq fuqi mendore
Dëshmorë të durimit që bijen të shkallmuar
Si shkêmbi, valash deti pa reshtur i sulmuar!
Nga vojtjet e të pa-anë që tretin pa mëshirë
Ç' do forcë q'e dërmojnë me dorë të vështirë.
Në prêhjen e të pa-anët i lirë të gëzohem
Nj' ashtu siç'po më k' ênda të çlodhem, të qetohem,
Dhe ç' do dëshirë-e ime mos epet e shpërngulet
Si tymi që shpërndahet prej erës kur përkulet!
Të veja dhe mê tutje nër vise t' ëndëruar
Në kthjellësi të qjejve të paqjes s' ameshuar,
Ku shpirtet ven' e çlodhen, atje ku kanë çerdhen
Si çlodhen meteorët kur rreze t'êmbla derdhen
Kur drit' e djellit çohet mi 'tâ me ngjyra t'arta
Tek sytë krejt të meren—shkëndija q'heth të zjarta,
Nër qarket e përtejmë pafundja tek po shtrihet
Mërgimi-i pa një masë tek endet e përtrihet
Nër botët lark që duken, nër trupa që lëvizin
Që ngjallen e që vdesin, ç' do frym' ato që ngjizin!
Që më një vênd në tjetër të mundja t'udhëtonja
I lirë si një shpesë që çohet pa pengime
Qysh rojn' atje të shihnja, ç'do send që t'a veshgonja
Në ka dh' aty të lumur, në ka dh' aty mjerime.
A n' êsht një vênd plot prêhje për ândje dhe dëfrime
Tek çlodhen zemërmirët edh' êngjëjt ku këndojnë

Ku shpírtet si pëllumba të lírë fluturojnë,
Në drítë t'amëshuar pa mjegulla, pa tyme
Lark, lark prej ç'do skëtere, ç'do ândje së përlyme.
Dhe veç aty nër híre, në drít' í lar' í lyer
Aty në gjí t'Empírít, të kêndít mê të vlyer
T' a gjej gjíthmonë prêhjen, një Gaz të kem, një Jetë:
Tej Lart në mê të Lartat, te Drita e Vërtetë!

BKSH

HYJI I HARRUAR

LASCIATE OGNI SPERANZA O VOI CH' ENTRATE
DANTE, INFERNO, CANTO III.

Unë jam një hyj që bota dô s' më njeh
Dhe sa thash' e thom kurrkùsh as dô të díjë,
Dhe në jap një gjyq sa mêndj' e tyre s' sheh
Kot e shpall, se s' ka se kujt, díkur t'í ndríjë!

Syrí-í em qëllon ç' do send kudò që rron!
Ç' do që bên e shoh, e mat me masë t' ímtë,
Se vështrímí-í em, hyn thell' e depërton
Ç' do që breth mí dhèt apò në det të rímtë!

Posht kursè jam ul, kam vojtur me qëllím
Njèrëzít t' í ndreq—sí njerës për të rruar;
Zbríta pa lavdí prej Fronít naltë t' ím
Frymë krejt të rè t'u jap për t' í ndrítuar.

N' emrín t' em hyjnor sot njëri tjatrín rren!
Vepr' e par' e kujt, vëllan' ësht për t' a shuar;
Jet' e tíja, faj, nër faje jetë gjen
Drejtësí sadò të kesh tí lígjëruar!

Që prej shekujsh rrí, pa prâ veshgonj mí 'tâ
Djell e hênë kam dëshmorë vjetërije.
As í rí as plak nuk jam síç' thon' atâ
Po, ç'kam qënë jam; pushtét kam Perëndíje!

Në një dorë mbaj një pishë, drítë-u heth
Rrugën t'u-a díftonj se ç' kanë për të bërë,
Por, në tjetrën kam dhe shufrë q' í përmbleth
Me të Gjyqít shteg në Ferr t' í kllas të tërë!

BKSH

AFRODITA

Jam Afrodita Perëndesha
Prej shkumbës detit e krijuar
Yllesh' e rallë jam,
Mi trupin, shkumbën un' e mvesha
Gjith botën për t' a zotëruar
Me hiret plot q' i kam!

Prej fundesh detí të pa-prekur
Prej valash egër që gjëmojnë
Kujtdo q' i fusin tmer,
Me hov e vrullë duk' u-ndjekur
Kur njëra tjetrën e kalojnë
Më keq se sa në Ferr,

Q' aty kam dalë shtat-krenare!
Kur pikat uji prek në dorë
Në sumbulla i ndronj,
Me forcën t' ime magjistare
Margaritarësh thur kurorë
Kurdo që dëshëronj!

Prej Ruzollimit të pa-masë
Prej qjejsh dhe hyjsh që tej shëndrisin
A çpallin tym e zjarr,
Prej drítës posht që vjen t'u shkasë
Mërgimet si rufè q' i grisin:
Q' aty fuqin' e marr!

Nga pikat uji t' ameshuar
T' Oqeanit q' un' e zotërova
Shpërndava më ç' do skaj;
Shkëndijet zjarri të pa-shuar
Në hyj të ndritshëm un' i ndrova
Nër qjej me dor' i mbaj!

Në gjinjt' e Detit zbres të prêhem
Kur ditën qjejsh mê s' dukem fare
Q' aty të marr shkëlqim,
Që natën hyll së rish të bêhem
Me dritën t' ime shkreptimtare
Të prur mi dhe ndriçim!

BKSH

FJALE NE ERE

I

Pa durim e gojë hapur
Pres t' i hapë fletët qjelli,
Të shkëlqejë-i plottë djelli
Horizontin për t' a kapur!
Frymë-e bimë të gëzohet
Prej skëterrës së mërzitur
Që vjen shtrohet e pa pritur
Dhe rêndon që të largohet!
Drit' e bardhë le të shtrihet
Si pluhur i holl' i artë
Që lart shkundur gjinjsh të zjartë
Për t'i çfaqur toka hijet!
Të shëndrisin rreth sa janë
Të shëndrisesh dhe ti vashë
Të të çelen syt gjumashë:
Hir të mbushen an' e mb' anë!
Prap të nisin lodrat, vallet
Në lendinë të mbleruar;
Buzëqeshur e gëzuar
Nesh sicili që të çmallet!

II

Çil-u shpejt o qjell i murmë
T' a gëzojmë prap lirinë,
T' a shijojmë bukurinë
Jasht të dalim mu si turmë

Se gjê tjatër ne s' kuptojmë
Siç' e ndjejmë jo rrall herë,
Me që jeta s' êsht prëndverë:
Sa na mbetet do t' a rrojmë!
S' dimë fjalë, s' dimë gjyqe—
Le të flasë kush të dojë,
Se nesh pas, e thom plot gojë:
Ç' ka do mbetet?... veç do kryqe!

BKSH

MEMA

Fjal' e bukur, fjal' e shenjtë
Thellë zemrës q' i tingllon,
S' ka në botë gjê m' e shtrenjtë
S' ka sí mêmë kur kujton!

Mêmë mêmë, frym' e lartë
Rreze drite, hyll qjellor,
Plot mëshír' e mall të zjartë
Engjëll-rojë madhështor.

Që nga gjínjt' e saj të dlírë
Vílet jeta pa shtërím;
Që nga zemr' e saj ka mbírë
Dashurí dhe mallëngjím.

Sí nër gaze dhe nër vojtje
Veç një mêmë të larton,
Sa ka frym' e sa ka rrojtje
Mêndjes kurrë s' të harron.

Ç' do rezíkut rrí të ruan
Bên dëtyrë sí luftar,
Sí dëshmorí heq e vuan
Për të zemrës saj thesar.

Gjíth me kêngë plot magjíje
Teje pranë që në djep,

Kêngë mallí, trímërije
Kurrë tjatër që s' t' í jep.

Bashk me puthje dhempshurije
Sjell vështrimin êngjëllor,
Siç' njëj mêmës í ka hije
Me sy t' êmbël e gazmor!

Më ç' do grimë fjala mêmë
Çase t'êmbla të përmênt,
Për mëngjes edhe për mbrêmë
Dhe kurdo q' e sjell ndër mênt.

Kush s' dí vlerën e njëj même
Esht pa ndjenj' e shpírt-mízor,
Bír skëterr' e frymë nême:
Esht í vehtes tradhëtor!

BKGT

LULJA E ZEMRES

—Ç' të dhemb o djal' e ç' të lëndon
Të dinja trim e plot vullnet,
Pse syrí rreze s' të lëshon
As buza mjaltë më s' të qet ?

Pse djal' o tretesh pa t' a ndjesh
Ç' do skaj í botës kur këndon,
Pse zemër-pikur gjíth të jesh
Hírplot zefírí kur fërmon ?

Këtâ thesaret q' í ke sot
Thesare vlerën që s' u-a dí,
Më s' do t' í kesh o djalë mot
Kjo mos të duket ty çudí !

Këtê prêndverë që shkëlqen
Sí gur í shtrênjtë drítëplot ;
Këtâ të rít' e tu s' í gjen
Në derthç e kroje píkash lot !

Kjo lule-e zemrës që të mbíu
Me kaq të thellë dhempshurí,
Dhe trupít degët që j-a shtríu
I thonë : Lule-dashurí !

Së parí duket një ëngjëllush
Me krahtë vjen të ledhaton,

Pastaj kur ndrohet në djallush
Me mij' shjigjeta nis të çpon.

Me thumba bisqet i ka plot
Ç' do thumb si mbleta të pickon,
N' i rênç dhe detit krejt më not
S' i-a zbutin helmin që kullon.

Se rênjët thellë kur i ngul
Shkëndija zjarri brênda shrep,
Sa, mê të fortin e përkul :
Dhe shpirtit prêhje mê s' i jep.

Në do, bir, jetë që të ndjesh
Të shohësh dritë krejt të rè,
Në do i lumtur që të jesh :
Ç' do ândjes tepër ver-i frè !

BKGH

LUTJE

(VARGJE ROMANTIKE)

Vajz' e bukur
Më je dukur
Drítë jete plot shkëlqím ;
Pa lëvdatë
Ke dhuratë
Që prur gaz e dëshërím
Me plot mall e ngushëllím !

Sy-verore
Zê-hyjnore
Që më çel me hírín tênd,
Faqe-dardhë
Gushë-bardhë
Që shpall rreze kênd-e-kênd
Rreze tretur gjíth n' êrgjênd.

Buzë-kuqe
Si burbuqe
Erë lulesh kundërmon ;
Píkë vese
Ngjallje shprese
Ç' do të dhembur q' e shëron
Kur plot ândje dashuron.

Syrín çíl-e
Si kandíle

Që shenjtorët i ndriçon;
Ledhatare
Fis-bujare
Eja zemra të kërkon
Drítë teje dëshëron.

Hap-i krahtë
Pa zembratë
Por si nj' êngjëll shpëtimtar,
Fal-m' i gjinjtë
Mes-kërthinjtë,
E më prít më prít me zjarr:
Pa le t' jet' aty një varr!

BKSH

BALLADA E BARIUT

Në rahje drite, malesh i qarkuar
Ish një pallàt me pamje madhështore,
Tek rrij një bijë mbretí sy-qjellore
Me flokë t' artë, krahve të lëshuar;
Hyllèsh' e bukur, plot rísí verore
Magjí shpërndante, hire perëndije,
Sa, trëndafíle, vjolca dhe shpatore:
Nakàr í kíshín nga q' u bênte hije!

Në rahje zemre mallí të pa-shuar
Nër êndra dehje t' êmbla dhe gazmore,
Prej buzëqeshjes saj përkëdhelore
Dhe zoqtë cmírít zên' e kíshín ndruar!
....Së largu n' erë tíngëll víj këmbore
Dhe fyellí me vaje dhempshuríje;
Me dhen rreth píkaloshe dhe leshtore
Rríj një barì që tretej dashuríje!

Në rahje shpresash, êndrash í-errësuar
Prej bukurís' së rall' e shëmbëllore,
Me drídhje përkëdheljesh prêndverore:
Drítares syt' í çonte pa-pushuar!
Q' í vogël íkur vatrës tij príndore
Pa shokë dhe nër víse vetëmíje—
Dh' ay massí krijesë që njerzore:
Njëj zjarrít tretej, zjarrít djalëríje!

Në rahje mêndje trurí të munduar
Me drithma të pa-njohura trupore,
I shigjetuar prej së ndritshmes kore
Që mênt' e kres' í-a kishte mjegulluar,
Gjith príste çasín e së lumes ore—
Të lumen orë çasít mrekullije,
Që veç t' í prekte gishtín e njëj dore:
Sí shënjë njohje, shënjë miqësije!

Në rahje gurësh ují të kulluar
Me vrull' í derthte valat tingëllore,
Një lumë rreth banesës mbretërore
Me píka mij' ylberesh í trazuar!
Kur djellí shkrepte rrezet mëngjezore
Një zê díl valës rrebtë, zê magjije,
Aq sa gjëmonín grykat malësore
Dhe drita, tingllesh endej fije fije!

— Më kot po pret tí buzët êngjëllore
T' asaj që kûrr' o djalë ty s' t' í bije,
Aty qendrô, me lulet rrô fushore:
Barí, njëj bije mbretí s' í ka hije!...

.....Në rahje fletësh vjeshte së vonuar
Dhe lote hyjsh e hêne mbrêmësore,
Nër blegërima berrash fat-mízore:
Heq shpírtín një barì pa u-kunguar!

LUTJE E VONUAR

O Zot pse vojtjet nuk m' í sheh
As lutjet gjunjsh kur víj t' í bíje,
As herë syt' e míj q' í ngreh
Ndaj ty me lote dhempshuríje.

Sí murgu falem për mëngjes
Të gjej shpëtím e pak mëshírë,
Për ças bekímin t' ênt e pres
T' í gjuaj çaset e vështírë.

Fort mir' e njoh se s' ka pajtím
Po bêre faje të menduar,
Dhe lotesh e në bêfsh burím
S' í luan nomet e caktuar.

Por unë s' di se ç' faje laj
Kurrkujt të keqe s' í kam bêrë—
Veç n' êsht q' e Míra zíret faj ;
Aher' s' í gjendet botës sêrë.

Andaj sí nj' êndër, mítuní
Dhe tallje m' êshtë dukur jeta,
Se pas mjerímít lumëri
As sa një drudhë shíje s' gjeta.

Se dhe në pata një gëzím
S' e ndjeva dot në jetën t' eme,

Ç' do vrer e ndrova në durím
I shkova dítët me pandehme.

Një rreze qjellít príta kot
Vargonj të thyej dhe mjerime,
U-bínda fatít fuqíplot
Si trím í rahur nër luftíme.

Më kot êndrova, pa t' êndronj
Me sot me nesër t' jem í lumur,
Mjerísht, í lumur s' jam vështronj
Po robí-í vojtjeve pa numur!

BKSH

HIJA E KEQE

Një mbrêmje me të vajtur tek shtëpíja
M' u-pâ díkush m' u-qas,
Kur shoh për qark, vê 'ré, më zu çudíja:
Gjê s' pashë meje pas.
Në dhomë, pa kujdes kur hyj të shtríhem
Te dera díç' më shtyn,
Qëllônj në t' èrrët, bênj síkur po fshíhem
Por gjê s' m' u-duk se hyn.
Të ndes pak drítë shpejt me mênt e zgjodha
Të shoh kush po më do,
Kur shkrep e flaga shuhej, krejt u-drodha
Dhe ngríva domosdo.
Ndeh duart posht e lart, tekdo kërkova
Verejta shtrat e mur,
Më vênd qendronj dhe sa me vesh përgjova
Veç ora: „tík-tak" thur.
Të flej u-shtríva, syrí dot s' m' u-qepej
Me gjakun në trazím,
Por lodhjes, von qepalla zu të m' epej
Nër pamje pa kuptím.
Në mes të natës, krejt një natë tmerrí
Dëgjonj se díç' trokèt,
Me vrap prej shtratit hídhem un' í mjerí
Por vesh nuk marr ç' po ngjèt.
Tek dera shkonj e pres mos përsërítet
Mos tfaqet nonjë gjê,
Kur, tek drítarja qelqí ze trondítet

Por shoh... se s' ka kurrgjê!
Me vrap veshgoj tryezën më ç' do anë
Pak dritë s' gjej të shkrep,
Sikur një dor' e fshehtë q' ishte pranë
Ç' do send m' a hiq me grep.
Gishtrinjt' e mij po shkasin duk' u-dridhur
Siç' dridhesh në të keq,
Shoh si-kur me magji ç' do send ësht lidhur
Në mest se lot një dreq.
Në shtrat prap bije, pres e pres të gdhihet
Kjo natë si një Ferr,
Kur, ndjej një dorë ballit qysh më shtrihet:
Një hije q' ep e merr
Më çast në trup ndjej djersat si më shkojnë
Në syt shkëndija shoh,
Sikur do maja thumbash keq më çpojnë
Dhe gjaku se m' u-ftoh.
Në t' errët hapa syt' e sa më mundej
U-hodha si-i pa frè,
M' u-duk shtëpija krejt sikur po tundej
Dhe fryma se m' u-prè.
Se hije nate që me mish e koska
Në trut më zuri vênt,
Më preu, kur pashë jeta si m' u-soska
Kur shoh seç' ka ndër mênt.
Më rrij gjith pranë-e si-kur për t' u-tallur
Ze gojën shtrembëron,
Shigjeta drejt në zemër duk' më kallur
Syt' egër kur m' i çon.

Vështrímet heth mí 'tê; më dridhet trupi
Gjësend síkur më mbyt;
E ndjej sí më tërheq, më mban nga supi
Një zjar sí nxjer nga syt!
Dy sy të zínj, sí vríma pellgut thellë
Levísnín plòt me tmerr,
Dhe prej njëj gojës hapur sí një shpellë
Një gjuhë flage nxjerr.
Dhe flokt' e kresë í kísh përpjetë ngrítur;
Dy brírë sí gjërprínj,
Turínjt' e kokën shtríge së mërzítur;
Me dhêmbët sí kërmínj.
Dhe kraht' e saj sí lakuríqí-í natës
I ndeh, í hap, í mbleth,
Me bark sí kafshë-e kêmbët bíshtí-í shatës
Një pamje që të ngjeth!
Do thonj të gjet' sí gjêmba ferrash rítur;
Një bísht që prapa ngreh,
Më kêmbë drejt qendron gjíth duke prítur
Se ç' do të bêj më sheh.
Po matem, në kam zemrë, që t' í sulem
Prej fytí shpejt t' a marr,
Në mos po gojës saja drejt t' í ngulem
Të gjej atje një varr.
Më vênd qendronj, mendohem që t' í lutem
Mëshírë t' í kërkoj,
Gjê me pahír mos bêj e mos të ngutem
Se soje nuk shpëtoj.
Mezí marr frymë sa të nxjer një fjalë

Kush qênkej t'a pyes
Tí dí ç' kërkon pse jetën të m' a ndalë
Të dí përsè po vdes!
Munt s' íshte gjê a mua munt më dukej
Mos nj' êndërr më mundon,
Por shoh me tmerr në vênd që tej të shdukej
Sí gjarpër më qarkon!
Sí nj' í pagojët q' ísha, shpejt marr veten
Në peshë-e ve ç' do ças,
Kokallat, thashë, fare të më treten
Mendova që t' í flas.
Hap gojën, luanj buzët, qysh nj' í tretur
Q' í luan kur heq shpírt,
Me zê të fort' í flas — sa më qè mbetur;
Sí nj' at í keq të bírt:
— Kush je tí, kush! që rrí me gojën heshtur
Ç' do çap që m' a ve 'rè,
Kush je pra tí, që pas më ndjek pa reshtur
Që prêhjen vjen m' a ngreh?
Kush je tí thuaj! mos gjê për të marë
Ke meje kur s' të njoh,
Me syt' e míj askurrë s' të kam parë
Dh' as dua të të shoh!
O híje, bíshë-e egër! ç' ke me mua
Që gjumín vjen m' a prísh;
Ç' m' a ndeh ashtu në syt' atê djall thua
Dhe faqet m' í gërvísh?
Lark meje prâ! Tí híje-e dalë Ferrít
Pa drojë që më nget,

Tej çporr-u, shduk-u, bíj' e zezë-e Ferrít
Me syt e tu që tret!
Me pamjen t'ênde, pamje sysh të dehur
Ndjej gjakun sí m'a ngrín,
Dhe gjuha jote sí një shpat' e mprehur
Shoh zemrën sí m' a grín!
Hiq dorë meje, hije shpírt-mízore
Hiq thonjt' e mos më ngaj,
Krahnorín cop' e fasha tí m' a çore
Q' as frymën s' munt t' a mbaj.
Tej çporr-u, ecë tjetërkund të gjuash
Ç' do shpírtín që t' a ngjall,
Me mua s' ke përsè kështu të luash
Të sillesh sí një djall.
Me ty s' kam marrëveshje-e as përqasje
Se s' jam një faqezí,
Për mua kjo do t' ísh një vetëvrasje
Sí rob e zemërzí.
Mos dô, të m' a rrëmbesh këtë pík' jete
Q' e ruanj me kujdes;
Nër aqë vênd në botë qysh nuk gjete
Një kërmë që po vdes?
Kurrkujt të keqe unë s' í kam bêrë
S' e kam këtê në gjak,
Dhe sí-kur t' a përmbysësh botën tërë
Fajtor s' më gjen aspak!
Po, për këdo kam qênë mirëprítës
Njëjt dorën s' í-a kam heq,
As kundra lígjes s' jam një kryengrítës

As prish ku s' munt të ndreq!
Qysh lulet i pa faj edh' i kulluar
E di që s'munt të jem,
Por shpirtin të t' a fal kanisk nër duar
S' e bëj këtë, t' a them.
Pa dasht munt zemra-e ime ka gabuar —
Ç' do çap sado q' e mat,
Por send që Zoti vet m' a ka dhuruar
Nuk ziret për mëkat.
Më k' ënda po, më k' ënda Bukurija
Dhe jeta më pëlqen,
Ushqim e rrojtje m' është Dashurija
Kjo shpirtin m' a dëfren!
Qysh uji jetëprurës i njëj prroji
Ç' do bimë q' e freskon,
Ashtu dh' ajo për jetën m' është kroji
Që gjakun m' a flakron.
Qysh era prëndverore vjen plot hire
Zefiri kur fërrmon,
Ashtu dhe forc' e saj e pa kufire
Më ngjall, më lartëson.
Me 'të veç ndjej zë këngësh krejt gazmore
Me tingëll magjiplot,
Me 'të ndjej ëndje, lumëri qjellore:
Pa 'të, një ças s' rroj dot!
Në qoft se s' kam as aqë gjë në jetë
Q' e çmonj më se thesar,
Por m' ësht' e thënë vojtje-e fat i shkretë:
Më mirë hyj në var!

„O hyj të hapësires qjellit kthjelltë
Përmblidhuni gjith tok,
„Dhe pshtillmëni me rrezet; shpres' e qjelltë
Q' e pres t' i-u kem sí shok!
„E bardha dritë çpall-u rrotull meje
Ndriçô sí hyll hyjnor,
„Këtê të murme híje, shpendë preje
Nde nêmët tej m' a çpor.
„Të lutem hap-i kraht' e tua dritë
Sí nj' êngjëll zbrit më mprô,
„Dëshirën mbush-m' a, bê-m' a natën dítë
Rrezikut më shërô!
„Të m' a rrëmbejë s' dua kush lirinë
Zot tjatër unë s' njoh,
„Përveç se vehten t' ime-e Perëndinë
Në shpirt gjithmon q' e shoh!"
Shpejt një levizje duarsh sysh më bêri
Një gojë hap pa frè,
Të më përpínte doj sa jeshe-i têri
Me frikë po vê 're.
U-drojta, gojës mos t' i bíje preje —
Me grusht e mat t' a prek,
Kur, zêri-i saj gjëmoj, gjemím njëj reje
Një tjetër kur përpjek.
Pik zê s' më mbet, dhe gojën porsa mbylla
Shoh buzët q' í levís;
Sí gur më vênd qëndrova, i zbet' sí dylla
Kur, heshtjen vjen e grís:
— „Që në vogli të ndjek! Kudo të luash

Pas gjyrmën ty t' a marr,
Qoft dít' a natë, vehten sa t' a ruash
S' të ndahem gjer në varr!
Tí bên síkur s' më njeh, po kurdoherë
Më ke gjíth pranë pas,
Ç' do kohë t' jetë, dímër apo verë
Pa prâ gjíthmon më has!
Tí do s' më sheh, por të ndjekín syt' e míja
Kudo të mfshehesh tí,
Për dorë dhe në t' arthtë-e Perëndíja
Pík droje s' kam prej tíj.
Qysh merímagës míza thonjsh í bíje
Në t' endurat e saj,
Dhe tyn' í mjer' ashtu të los nër fíje
Prej grushtít t' em s' të ndaj!
Po, fatín e kujtdo e kam nër duar
Me 'tê sí dua los,
Çanj dyer hekurí sado forcuar
Me pamjen í farrós!
Besonje se nër thoj nuk do t' më bíjesh
Të dísh se cílí jam,
Por dhe në fund të detít po të líhesh
Në dorë prap të kam.
T' í njoh dëshírat aq për 'tô që tretesh
Në tru të dí ç' mendon,
Por kot, se kurr' atyre s' munt t' u pshtetesh
Kur shortí të gjyrmon.
Të k' ênda-afrímí-i buzave të buta
Gjê zemrën që t' a ngrohn,

Por dij-e, helmin unë q' i-a u futa
Krejt jetën t'a shkurton,
Dhe përkëdhelja-e duarve të holla
Që faqët t' i limon,
Zilin'aty prap unë jam q' e mbolla
Që mëndjen t' a shkallmon!
Mënjanë ler-i êndrrat lumërije
Q'i sheh veç për një ças,
Gjith sa të k' ênda janë vetëm hije
Mas 'to, ke lote pas.
I mitur e pa mênt, prap foshnjë mbete
Sado që pe më syt,
Qëllimn' aspak s' i-a njohe ti ksaj jete:
Padija keq të mbyt.
Qysh nj' errësirë-e dêndur pyllit thellë
Që drita s' e dërpton,
Ashtu dhe trut' e tua janë pshtjellë
Me natë q' i verbon;
Tani, tani ti ver-e 'rè voglinë
Kurgjê njeriu se s' njeh,
Me lot nër sy kujton kot Perëndinë
Kot duart qjejsh i ngreh.
Qysh valat e pa masë shpesh që ngrihen
E bijen me tërbim,
Sa forcës s' eme duan që t' i mfshihen
S' u fal pik përdëllim.
Hith syt' e mat-i kohërat e vjetra
Me mij e mijra vjet,
Ndryshim se s' kanë; njëra qysh e tjetra:

Një fat gjithmon i pret.
Sa frone, s' janë gjer më sot përmbysur
As gjyrmë që s' u mbet,
Dhe Kombe kryelartër as janë ngrysur
Gjith unë q' i kam tret.
Në luftë-e zihje njerëzín' e têrë
Jam zoti q' e përlesh,
Kufomash grumbuj Fronín m' a kam bêrë
Dëshira kur m'a desh.
Qytete dhe fortesa bíjen preje
Dërmohen, bêhen hi,
Shênjtorët nëpër tempujt para meje
Krejt s' kan' aspak fuqí.
S' u-ndoth t'i matet kush fuqísë s' eme
Por as t' i dalë zot,
Kush thotë se më munt, rron me pandehme
Ndë t' errët breth më kot.
Mos u-mundô pra kot të ruhesh meje
Nga dora s'më shpëton,
Sadò n' u-shduksha prap jam rrotull teje
Më has ku tí s' beson.
I çmêndur! unë ty të kam nër leqe
Tekdò në vafsh të ndjek,
Se jam ajo q' i thonë „Hije-e Keqe:"
Jam Fatí që të prek!"

MOS HUMBNI SHPRESE

Sa jíní të përunjur
Që s' ngrehní dot as kokë,
Të shkelur, të lënduar
Të mjer' edhe pa shokë,
Mos humbní kurrë shpresë
Se ka për ju shpërblesë !

Ju pa të bardha dítë
Me djersa që punoní,
Që ngryseni pa bukë
Dhe gjumít që pikoní,
Mos humbní kurrë shpresë
Se ka për ju shpërblesë !

Sa qaní pas së drejtës
Me lote hídhërími,
Dëshmorë të së keqes
Për hir të njëj qëllími,
Mos humbní kurrë shpresë
Se ka për ju shpërblesë !

Sa rroní plot kujdese
Nevojave të shtyrë,
Sí pênd' e hollë n' erë
Andej këtej të fryrë,
Mos humbní kurrë shpresë
Se ka për ju shpërblesë!

Sa vení me pandehme
Për dítë mê të míra,
Por fatí-i shkret' í-u tallet
Me çase të vështíra,
Mos humbní kurrë shpresë
Se ka për ju shpërblesë!

Dhe ju por sí shenjtorë
Ashketër q' agjeroní,
Me falje dhe me lutje
Mëkatesh të shpëtoní,
Mos humbní kurrë shpresë
Se ka për ju shpërblesë!

Ju njerës zemër-mírë
Që dorën hapní gjêrë,
Ç' do plagë të sheroní
Të míra me të bêrë,
Mos humbní kurrë shpresë
Se ka për ju shpërblesë!

Ju êngjej në fytyrë
Por djaj në zemër t' uaj,
Që shkelní porosírat
E ligjít, besës s' uaj,
Mos humbní kurrë shpresë
Ka dhe për jû.... shpërblesë!

KOTESIA

Nëpër qytét nër kisha gjith të vjetra
Do varre shoh rrënime, të harruar,
Përmi mermert q'u-duken disa letra
Mishkrime të njëj jetës perënduar.

Ça, thyer copra posht' e lart të hedhur
Disa si për t' u-tallur bërë shtrojë,
Të tjerë grumbuj murit pranë mbledhur
Si gjê që s' ka mê kush për 'tâ nevojë.

Shkon bota, syt' i heth mi tâ shum' herë —
Por si ç' do send që shpesh e gjuan syri,
S' i jep ndopak as rëndësi as vlerë
Kur sheh se gjê, në pun' askujt s'i hyri.

Kush munt t' a dijë ç' kanë qënë vallë
Se letrat krejt prej kohës janë ngrênë,
Veç si kuror' u-duken lart në ballë
Do flet' ullinjsh e lisi rrotull vênë.

Kush munt t' a dijë me sa shpresa rrojtnë
Atà q' i dirgjen hijes s' ameshuar,
Kush di me fatn' e njerësve sa lojtnë:
Sa ranë fli nër kêmbët tyre shtruar.

Me lajka munt sa qenë gjallë rrojtnë
Munt pa kujdese jetën e mbaruan;

Mê tej se vehtes tjatër botë s' njojtnë :
S' u dhembi munt sa lotte që pikuan.

Pas, munt se lanë bij q' i tanshëguan
Nër ândje munt që pasjen e shpërndanë ;
Veç për një copë her' edh' u-harruan :
Qiri të ndezur buzë varrit s' panë!

Besonin se po vdiqnë vet' një herë
Ka për t' u-ndritur varri për gjithmonë,
Nuk' dinin se do flenin si të tjerë
Q' as shênjë mê s'u mbetet në të vonë.

Kurrkujt s' i dhemp, për tâ, kujdes të ketë
Përsipër shkelin njerës dhe bagëtia !...
E vetmja veprë pa themel në jetë
Nj' ashtu si ç' po u-a donte kotësia !

BKSH

KENDO-ME ÇUN!

Kêndo-më çun gjësend të rè
Një kêngë mallí tí këndo-më
Me zêrín t' ênt tí më dëfrè:
Të rít' e míja, çun kujto-më.

Më síll ndër mênt ç' do ças që shkoj
Ç' do ças të jetës q' u-gëzova,
Me hír të jem kur t' í kujtoj
Sa gojës s' ate që dëgjova.

Kêndo mê rall' e dal nga dal
Se kêngës s' ate-í paska híje,
E ndjenj o çun, të qofsha fal
Sí tínglli-í saj në zemër bíje.

E dí se s' jam í rí sí ty
Por zjarí-í fsheht më mban pushtuar,
Kur í përmênt ata dy sy
T'asaj q'e pata dëshëruar.

Kêndo-më, çun gjësend të re
Një kêngë mallí tí kêndo-më,
Me zërín t' ênt tí më dëfré
Të rít' e míja, çun kujto-më!

SHIH SI ENDET BOTA...

Pa shíh sí endet bota kudô në hapësírë
Tej hyjt sí fërfëllojnë pa lodhje-e pa pushím,
Qysh sy për nat' në rojë me drítë të pa-vdírë
Nër caqet e mërgímit në shkas pa pík mbarím.

Me ngjyra trëndafílí në píkë të mëngjezít
Nër qiej sí enden rrezet qysh míj e míj gjíshtrínj,
Me vrap q' í derdhen natës sí shtríga hepur mezít
Për fytí që t' a kapín t' a thíthín sí gjërprínj.

Shíh nata fíje fíje në gjí plot t' ameshímít
Nga dal sí ngjízet, drita n' avushë sa q' u-tret
Kur djellí-í lodhur, kryet í ul pa pík vrapímít
Nër vetullat e rêve por sí nj' í krusur mbret.

Shíh êndrat sí po enden në gjínjt' e natës thellë
Nër botat e pafundme kurrkush që s' í mendon,
Ku ndjen e sheh aq sende q' as mêndja s' munt t' í pjellë
N' atê pafundje tmerrí që sy e ndjenjë s' e kupton!

Pa shíh dhe dashurija nër míj' e míj' krahnorë
Pa prâ sí reh edhe-endet qysh gaz e lot shbërthen;
Ner aqë syth e buzë q' í pjekín aq dashtnorë
Kur mallí-í zemrës çohet prej fundí që s' e gjen.

Pafundje jete çpallet nër bota pa kufíre
Ç' do trupít, syt q' e prekín, që drítë çon a merr,

Një fat q'ţu dha Krijesa n' atà pa masë gjíre:
Kush lind, kush vdes, por vdekje një jet' të re që tjerr!

Pa prâ në trut' e jonë qysh enden mij' qëllíme,
Mendímet si përpíqen pa masë-edhe pa fund,
Parrajs' a Ferr na duket nër ândje dhe mjerime,
E ndjen se rron në botë; por sheh se s' rron... kurrkund!

BKSH

MISTER!

Nuk dí, në trupín t' em në kam
Një shpírt, díkûr që munt ka rrojtur,
Që munt ka qeshur a ka vojtur:
Nuk dí, në brum' í tíja jam.

E shoh, e ndjenj se sí levís
Një frymë tjetër, frym' e huaj;
Lírisht kur dua që të luaj
Më vênd më mban gjêsend po nís.

I zotí s'jam që t' a kuptonj
Në trut' e mij sadô kulluar,
Fuqí t' a njoh s' më rrí nër duar:
Përbrênda ç' kam t' a përjashtonj.

Ky shpírt që gjakun m' a pushton
Nuk, dí, ç' kríjesë vall ka qênë;
Nj' í pasur a po nj' í pa-ngrênë
A një që botën njohu von.

Nuk dí, në mbret ka qën' a rob
Mundonjës a po í munduar,
Në shkoj një jetë mê udob
A po n' u-shojt í dëshpëruar.

S' dí sí t' a marr e sí t' a nís
Të dí dhe unë se s' jam unë,

Dhe si ç' e nis ashtu e gris
Kur shoh se fund mê s' ka kjo punë!..

Shpesh herë vehten e pyes
Por një përgjigjje kurrë s' marr;
Myster që mbetet gjer sa vdes
Që tretet bashk me ty në varr!

BKSH

PENDIM EGOISTI

Síkur e ndjenj qysh poplat bíjen rêndë
Përmí qívurt që trupín t' em e mbyll,
Dhe ky, sí nís e tretet sí ç' do lêndë
Dhe shduket sí ç' po shduket lart një hyll.

Sí plumb më shkon ç' do poplë që po bíje!
Një ças í tmertë, ças dërmímí jete,
Muzíkë-e ashpër, drithma që të shtíje
Kur syt t' a shohín rrugën se ku vete.

Atje në t' errët, varrít t' ameshuar
E ndjenj qysh trurít t' em, një dorë peshe,—
Në 'të një botë q' êsht e pasqyruar,
Kurrgjê mê s' mbetet, ç' do që munt të jeshe.

E dí, se Ferrín munt t' a kem banesë!
Për ç' do mëkat qe kam, sí gjê shpërblímí,
Prej ç' do se Míre do të kem mungesë
Dhe shpírtí-í em, po, preje-í ç' do mundímí.

E shoh qysh djajtë bredhín rrotull meje
Në prush e flakë shpírtín sí m' a flakín,
Qysh njëj mohonjësít kanuní feje
Në të përjetshmín zjar sí m' a përflakín.

Sa për Parajsë, shpresat í kam thyer—
Këtê në jetë kurrë s' e mendova,

Se një të mirë dhe në pata kryer
Prap' unë jam me fajet q' e dërmova.

I rí kur jeshe kurrë s' e besonja
Ky syrí-í em që shkrepte zjar e flakë
Të shuhet sí kandíl pa vaj; s' mendonja
Se sy të tjerë s' ka më t' í përflakë.

Sí nj' í pangopur etjes luměríje
Në gjínjt' e saj të kândêshm u-lëkunda,
Pa díjtur se këputet sí ç'do fíje:
Të njoh — se s' doja — ç' ka më tej se hunda.

Në dêm të tjetrít desha që të rronja
Këdô kur doja shpírt me mos í lênë,
Në jetë më kísh ênda t' a vështronja
Përdhè të shtríhur, thundrës s' eme vênë.

Por Fatí që mes dorës tíj mízore
Trondít me grusht themelet e Krijesës,
S' duron t' í-a shkelësh lígjat themelore
Tí, që pushtetít tíj í ngjet përdhesës.

Se vjen një kohë, le t' í thom pendímí
Kur vuan keq e dergjesh faqe-shuar,
Kur trupí-í brejtur êndjesh dhe dëfrímí
Mí majra thumbash lot í dëshpëruar,

At' here syt' í hap sí nj' í hutuar
Dhe thua: ç' faj në botë vall' kam bêrë,

Pa pik mëshíre t' jem kështu dënuar;
Një mal í math të nxêrë në një vêrë?

S' të shkon aspak nër mênt se kush ke qênë
Ç' do faj të bêrë shpínës duk' e hedhur;
Përbuz Shênjtorët, vêndín për t' ua zënë
Tí, së Vërtetës fytín q' í-a ke dredhur!...

Dëshmonj q' aspak për vdekje s' kam dëshírë
Dhe sa mê lark të jet' í lumtur ndjehem,
Por, kur aq faje-e lot' ajo ka fshírë
I bíndur jam se po, me 'të s' gënjehem!

BKSH

JUDA I RI

Jo vetëm Krishtin e ka shitur
për ca të holla
dishëpulli „besnik" i tija Juda!
Jo vetën Juda me një puthje ‚kreshniku" —
me buzët tij si sholla
mi ballët Krishtit duk' i-a ngjitur
dha shëmbëll tradhëtije miku!
Dhe Krishti — Hyj që zbriti si njeri
duroj; nj' i Mirë, siç' duron
të keqen duk' e pritur
me dashuri!
Pra, mos ju zêrë çuda
se s' gjen dhe sot si miq e dashamirë,
fytyrë-shtaze-e frym' armiku,
si Judër që të puthin, „t' adhurojnë",
por siç' e kanë për zakon:
as mik as fjalë mos nderojnë!

Si dashamir i vjetër
një, dorën vjen e t' a shtrëngon,
t' afrohet e të flet si jo më mirë
sa fjal' e tij të përkëdhel e të limon
dhe thua se si „ky" s' ka më tjetër:
në shpirt se ç' ka ti pa t' a dish!
Kur hyn të pret me brohori
të thotë „mir' se vjen",
më kêmbë qoft' a po i shtrirë,

të fton gjíth pranë shpesh t' í rrísh
plot nënëqeshje gruaje së fíkur
dhe me vështríme kukuvaje që kobon
të mban për dore përsëri —
edhe në je për t' íkur!
Tí pa mërzí,
sí zemërbardhë fjalët í-a dëgjon --
e nga të tuat, munt e jetën í-a rëfèn,
sa tyn' aspak në mêndje s' të gërvísh
se míku qênka zemërzí:
kur sheh edhè se të lëvdon!

Por soje ruaj-u sa munt
se në bísed' ay të qep edhe të çqep
të blen edhe të shet,
t' a merr e mêndjen tí q' í jep!
të rëmon e të gërmon
me zemër-lígësín' e tíj pa funt.
Largo-í-u syrít tíja sataník
dhe dorës tíja që të vret,
tej çporr-e te këtílle mík
për sot e për gjíthmon!

Sa veta sí dhe Krishtí s' janë çuar
në Golgothà
nga njerës të këtíllë, që të shesín
për pak ërgjênt!
Sa veta nuk e zbrasnë kupën rafsh me vrer
nga míq

pa nder
e zemër-liq!
Për 'ta mëshirë s' ka n'u rè në pluar —
e sa s' u kanë rênë!
se ndjenj' e tyre gur u-bê, sí bar u-tha
dhe gjakun helm në trup e kanë kênd-e-kênd
sí krua gojës q' u rjeth, u kullon!
se Judër kanë qênë
dhe têrë jetën gjíth t' atíllë mbesín —
sado dyshímit s' duan që t' í lenë vênd,
sado që çfaqen të kulluar,
por puna del në shesh e mê s' vonon
se faqas duket ç' do që kan' atà punuar!

Por díj-e Juda fís-mallkuar
në jetë gjê të shênjtë kurrë që s' ke pasur
sado sí gjarprí helm heth ku kafshon
dhe mu sí Hydra kryet prap í nxjer,
por fatít që të ka nër duar —
sí gjíth ata me 'tè që janë hasur,
as tí atíj s' í ke për t' í shpëtuar!
Se ka një nom që na gjykon
se rremës maskën që í-a çjerr
rufenë thellë q' e dërpton
në shpírtín të kujtdô
të zeza që po tjerr!
Dhe lígj' e shênjtë thotë:
kush kordhën e gënjeshtrës e përdor
për një qëllím të keq kurdo,

dënimí do të jeť í plottë!
se dhe në munde sí Ngadhënor
po prap í mùndurí mí ty qendron,
ashtu sí ngjet në botë
kur del një Tradhëtor!

BKSH

LULET E GJIRIT

Me lulet, bukur vênë drejt tek gjíret
Po sa të pashë-o êngjël í uruar,
Më dukej se në 'to vështronja híret
Një dorë mjeshtërore q' í pat shkruar.

E ndjenja krejt qysh mêndja po më mírret
Kur syresh rreze drite-e pa shteruar,
Por sí prej njëj thesarí që nuk vdíret
Përhapeshín plot jete t' ameshuar.

S' m' a ndjeve etjen shpírtín që m' a díqte
S' kuptove zemra qysh më bíj pa masë,
Ndaj ty një mall í fsheht' sí më tërhíqte.

Sí lundrëthyerí që kap një drasë
Me hov plot shpresë valat t'í kalojë....
Zê s' qíta dot, m' u mbyll e shkreta gojë!

RUGTARET....

Ndaj majës bregut gur e lís rethuar
Një kíshëzë-ësht pa príft e pa këmbanë!
Për meshë-atje rall fort besníkë vanë
Veçsè rugtarë natën për t'a shkuar.

Mí kryq te murí, motít í harruar
Sy-vrarë Krishtí kryet mvar mënjanë,
Te kora me kandílin shuar pranë
Kqyr Vírgjëresha faqe-e sy vranuar.

Tíngllím hyjnòr sí frymë Perëndíje
Një brítje me buçím prej heshtjes thellë
Del trollít ku rugtarët shtríhur, flenë:

Un' isha, jam, e do të jem! Ju híje
Pluhur e baltë! Trupí í juaj shpellë
Për ar ç' do send e shet: vëllan' e fenë!

KENGA E UDHETARIT

SAKOLI

Jam udhëtar í botës së pa-masë
As unë s' di nga vete dhe nga víj,
Kam vjete që po rend edhe po príj
T' aríj ato sa pamja ndjek t' í hasë.

Qytete, male-e sheshe syvet míj
Tej shduken, pas. kurkush pa që t' í ngasë,
Qysh tínglli-í njëj lahute del të shkasë
Pa díjtur se ku vete rrugës tíj.

Jam duke rendur shpesh me vrap rrufeje
Síkur prej njëj fuqís' së fsheht' í ndjekur
Pa një ndalím të shoh kund para meje.

E nata vjen më kap në shkretëtírë
Në gjínjt' e saj të murmë duk' më prekur...
Dhe prap í nísem rrugës me t' u gdhírë!

MEKATI I FSHEHUR

NUNOSJA E NJEJ MEKATARES

I

Uratë qofsh bekuar
Përpara teje víj me unjësí
Për ç' do që kam fajtuar
Që kur se në këtˈ botë jam njerí,
Veç ty të njoh edhe një Perëndí
Tˈ ju lyp me krahtë ndehur
Për ç' do që kam të fshehur
Një falje tˈ ameshuar.

II

Po, kam për tˈí dëftyer
Me radhë-e një nga një ty ç' do mëkat
Pa drojë-e pa gënjyer!
Por një s' tˈ a thom as kur të vdes në shtrat
Sepse ashtu kam pasur unë fat;
Të vdes në varr të mbetet
Me eshtrat bashk të tretet
Nër drrasat í mbërthyer.

III

Të dí, të njoh uratë
Prej gojës s' ate s' del as një dëshmí,
Kjo êsht një sí dhuratë
Për ç' do meshtar që mban në mjeshtërí!
Po për atê tˈa thom e përsëri

S' del mejet as një fjalë
Dhe shpírtí të më dalë,
Të bêhem eshtr' e thatë.

IV

Nër fajet që kam bêrë—
Se faj munt q' êsht kur shkelet ç' do lírí;
Njeriu nuk mban dot sêrë
Kur mplaket bên mê keq se një í rí
Se líndet edhe vdes gjíth mítuí,
E dí, ka pjesë djallí
Po zemrën kur m' a ngjallí
I tíj le t' jem e têrë.

V

Dí, se po t' a dëshmova
Prej teje ndjesën kurrë s' do t' a kem
Prandaj nuk t' a zbulova.
Kur dí në Ferr, në zjar se gjíth do t' jem
Se-as Perëndija nuk m' a fal t'a thëm,
Me q' êsht një gjê që s' thuhet
Me fjalë, por as shkruhet:
Sí foshnjat u-gabova.

VI

Dhe n' êsht se nuk gjej ndjesë
Për një mëkat që s' dua t' a dëshmonj;
Jo në Parajsë pjesë
Por as Shên-Pjetrít syt s' do t' í-a shëkonj

Po drejt në gji të djallit do të shkonj,
Faj ka gjith Perëndija
Në shpirt që ndes shkëndija:
Që bên ashtu krijesë!

BKSH

SHEGA

Posht tek manat nër lívadhe
Me një poçe buzë-thyer,
Goj' e duar kuqe-lyer
Po breth Shega sí sorkadhe
Man pas manít, e rëmbyer.

Era, hollë fryn nër fletë
Manat bíjen skuqín dhenë;
Gjarpër syt' asaj í venë,
I sjell qerthull — díhet vetë;
S' díj se ka dhe sy që s' flenë.

Në të mugët sí ca híje
Tunden plepat e kërcasín,
Erës fletët í përplasín
Shegës tmerr në gjakt í bíje;
Drithma trupít gjíth í shkasín.

Uj'í zallít shkumb' e valë
Qet míj' zêrra me t' u-derdhur;
Mbetet Shega dyll' e mverdhur
Kur nga zêrrat ndjen dhe fjalë:
Pas dokùsh mos t' í ket' erdhur.

Por sí tríme, s' í-a ka frikën
Ç' do rezíkut í bên ballë:
Doj të dínte kush që vallë,

Ndalet vêndít e mê s' íkën:
Por, s' pa híje gjêje-gjallë.

Era s' lodhet duke fryrë
Kur mê fort e kur nga dalë,
Flokët Shegës í-a bën valë
Qysh mí supe-e mí fytyrë
Fíjet derdhen palë palë.

Me kuxím të pa treguar
Ngrítur heret, gjínjsh e dlírë,
Zbret nër manat fushës lírë
Poçen doj për t' a rafshuar:
Mblíth e mblíth nga kísh dëshírë.

Puna s' vete pas pëlqímít
Të vesh dorë ku s' ke leje —
Qofsh e bíj' e njëj së veje,
Po s' í vure frè lakmímít:
Dorës tjetrít bíje preje.

Se dhe Lílí, trím sí Lekë
Prapa manít po rrí fshehur
Syt' e mêndjen í mban mprehur,
Po pret gjahun që t' a prekë
Drejt në grackët q' í pat ngrehur.

Lílí djalí 'rè kísh vênë
Për dít' manat q' í përfshíhen;

Shkunden erës, vetë bíjen
Një me dor' ay s' pat zënë
Dhe kusaret as që díhen.

Sí një híje Shega-afrohet
Pa mos díjtur ç' do të ngjasë —
Munt të zotín që t' a hasë;
Se me dreqín kurrë s' lohet
Dhe gjësend do të pëlcase.

Gjíth me mëndjen në të mbledhur;
Lot gishtrínjtë sí gërshërë
M' í mbleth manat gjat' e gjërë
Drejt në poçe duk' í hedhur —
Sí nga hera që pat bërë.

Pshtetur manít, shëmbëllevi
Se gjësend síkur leviste,
Príj me frikë gjë mos ngjíste
Sa dhe poçen díç' e thevi
Kur pa vajza se ç' e príste.

Me vrap Lílí, plumb í sulet
Me rrëmbim e kap për brezí;
Shega pâ, se puna ndezí
Doj t' í híqet e t' í çkulet
Por ay s' e líj nga mezí!

— Bjerr'-m'a poçen se t' a thyej
Shoh se qënke një kusare!

Mos e luaj dorën fare
Se, për besë, gjak të lyej
Po m' u solle kundërshtare.

Në fshat hiqesh zonj' e madhe
As s' të flet ty kush me gojë!
Kur del portës del me drojë
Po për mana nër luadhe:
Mê, për turpin s' ke nevojë!"

— Ler'-m' a poçen, Líl, të lutem
Pa ç' do faj kam për t'a larë!
Me ty s' dua t' jem e sharë
As në zihje s' do të futem;
Dí se je një djal' í mbarë.

Sheh se degët janë pranë,
Dhe kur era po fullonte
Pashë manat q' í rëzonte
Kur këtej e kur mb' at' anë:
Gjê që mua më dêmtonte.

Líl, për Zotín ty të pashë
Prapa manít q' íshe fshehur
Por me mêndjen s' kam pandehur
Që të síllesh aqë trashë;
Se në qesha, s' jam e dehur.

Sa për mana po të duash
Mblíth tí nesër nga të míjat,

Pse t' i shtojmë të këqijat
Kot të rrish e të më ruash:
Kur i ndreqim bashkë vijat!"

Plot me sjellje ledhatare
Dhe me fjalë, mêntt' i-a drodhi
Lilit zêmren diç' i-a mvodhi,
Me t' i falur mij' thesare
Dhe ç' do send asaj q' i ndodhi.

Manat qenë shkak i bërë
Se qëllimin, kush, s'e dinte;
Gjê në mêndjet n'ish q'u ndrinte
Dashuria, thom, e tërë
Ish ajo në gjak q'u shkrinte.

Gjith katundi vesh pat marë
Shegës gjê s' i mbet pa thênë
Mi të vjedhur se që zênë;
Dhe në dihej vajz' e mbarë
Nuk dolli si pat qênë.

Goj' e botës zu të bredhë
Gjêmë fjalësh soje rodhi—
Munt as ish ashtu si ndodhi
Se në, Shega doj të vjedhë:
Lili Shegën ish q' e mvodhi.

Vreshtës pjekur ishin rrushtë!
Dhe nga manat q' ishin „vjedhur"

Dil rakija-ajo mê-e zgjedhur!
Mollët kuqur mu si prushtë
Me sy bênin për t' u-mbledhur.

Që nga manat gjer në vlesë
Shum' i rêndë çapi s' ishte
Zjarr i ndezur flagë kishte;
Të dy zemrat dojin vesë
Si dhe lulet në lulishte.

Dasm' e madhe qysh gjêkundi!
Përmi shtresat vija vija
Sa s' i nxente mê shtëpija,
Lojti valle gjith katundi
Të kënaqur nga rakija!...

BKSH

BARESHA

VARGJE BUKOLIKE

Bareshë, me gjíret hírplot
Sí lule fushore tí je,
Pa fare kujdesít sí zot
Nër male dhe fusha më ngè
E shtríhur mí lulet përdhè,
Plot gazít me shqerrat që lot
Prëndverës kur del í kullot.

E pshtetur mí shkopín kur rrí,
Vështrímet me mall kur í heth
Më duket, bareshë, se tí
Në 'tò dashurín' e përmbleth!
Dhe kêngë kur zëri-í yt dreth
Dhe çpallesh me plot bukurí
Me dríthma më mbush e me magjí.

Bareshë, me sythít plot zjar—
Që zjarín me 'tà tí m' a ve,
Me flokët e verdhë sí ar
Unaza reth krahve q' í ke,
Me buzët që qesh e kur flè
Shpesh doja të jem një kusar
Kusar í të shtrênjtít thesar!

„FYTYREN T' ENDE"

Shum' her' e kam mallkuar jetën t' íme
Shpesh herë thom që s' dua më të rroj,
Por kur „fytyrën" ty gjíth t' a vështroj
Harronj ç' do vojtje jete-e hídhërime!

Por prap atê fytyr' un' e mallkoj
Sado m' a mbush zemrën me gëzíme,
Kur shoh se sa më tepër e adhuroj:
Ç' do prêhje shpírtí ndrohet në mundíme!

BKSH

DESHIRE PAGANE

O shpírtí í em që s' ke píkë prêhje-e qetësí
ti që ke gjetur nj'aqë vênd
që s' të përshtatet as një ças,
qysh nj' í dënuar për gjíthmon rrí
e vuan me pa hírín t' ênd!
Në dô fatbardh' o shpírt të jesh
kësaj kufome, sí një burg í keq
me hekura që të shtrëngon,
kësaj së murme híje thellë që tërheq
dhe që mundon:
díl, díl q' aty me plot kuxím
e mos í bjerrë pas!
aspak, shpírt, mos u-tremp
prej kërme pa fuqí!
Largohu, ler-e për mallkím
se nuk të prísh as që të dhemp
dhe flamën në j-a vênç
më çast n' e lênç
një send që bëhêt krejt pluhur e hí!

I qettë shko tek qjellí-í pastërt, lart
tek prêhja mbretëron pa funt
kufomën flak-e tej në zjart
në Ferr t' u bêhet djajve qêm
e shkund-u soje shpírt, sa munt!
S' u-ngope vall me 'tê:
s' e njohe sadopak nga syt

me heshta helmí sí të vret,
sí frymë-e keqe gjithënjê
're s' vure sí të mbyt
sí shuhet zêrí í yt,
të dalësh sulmín sí t' a pret,
qysh, tí s' e ndjen këtê?

Jo, jo, mos u-gënjè
kur thotë gjêrra mirë vehtja që s' í-a pâ;
me ândjet që të sjell
me fjalët e-êmbla që të bínt
me gjínjt a zjartë që të ndjell,
me përkëdheljet marrësíje që të përcjell
a po me lumërít që nuk í ka!
Se helm gjíthmon nga goja vjell
sí gjarpër gjuhët jasht kur í përcjell;
a sí kuçedra pa u-ngopur që përpín e ha!
Kur dí, se gjer më sot ay s' u-línt
që munt t' í verë ç' do dëshírej frè,
síç' vet' e ndjeve, vet' e pè
nga kurthí plot pengíme që t' u-ngreh!

Por dhe në qoft një ças se í shíjoj
do grímë lumëríje sí ç' í ndjeu,
ashtu atíj sí ç' í pelqeu
a nëpër mêndje sí ç' í shkoj,
tí mos beso sa fíje fjalësh që të dreth:
se mê-í pandohtur êsht se dbora që po sbarth,
se mê-í kulluar êsht se drita pa rè;

do shohç se njollat krahvet í ka heth!
Se vehten pakëz s' e gërmoj
t' í shohë fajet gjíth me dashje q' í punoj,
se syvet u ka vênë leth:
e ndjen se tí, sa bên, s' í-a vê 'rê,
andaj gjíthmon ty pas të lâ
me tallje-e shtrembërime goje-e njëj atheu
nga têrë-anët gjíth lëvdohet pa prâ
se veprat tíj mírësíje s' kanë garth
dhe lígjít shênjt të Hyjít nuk í-u nda;
kur vet me dor' ay
ç' do tempull hyjësíjet e dërmoj
sí bíshë, krejt pa mênt e sy!

O shpírt, mos e beso sa tha
se me mëkate vehten plot e ka
dhe ty pa pík mëshíre të mbërtheu
pa të mendohet të dënoj
sí ç' u-dënua Prometheu!

Pra líps-u, ler-e këtê trup-qen
edh' ec' í shgjeshur e plot ngazëllím
në Paradís, në t' hyjëshmín Eden,
tek Indra Hyjí-í math banon
qí me fuqín' e tíj pa masë-edhe pa funt
sí Zot í Botës edhe Mbret,
ç' do shpírt nga Nírvana që shkon
përpara gjyqít tíj nuk shpëton;
se syrí-í tíj me të vërtet

gjíth tokën an' e mb' an' e depërton,
Ay të keqët í dënon pa prâ
nga dora heth rrufen' e vret
sícílíndo që Lígjes tíj u-nda!
Dhe zemër-mírët plot bekím
nga vêndí, kush, s' í tunt
por ven' atje ku dríta s' ka mbarím.
Atje, o shpírt, tek do të gjesh
dhe tí, një qjell që qesh
plot prêhje dhe pushím
dhe jetë n' ameshím!

BKSH

KUJTIME TE SHKUARA

Ku munt t' ju gjej o shokë djalërije
Që t' a shijoj prap kohën e pëlqyer,
Të çastit që na mbushte lumërije
Kur losnim varg, me gaz të pa-dëftyer?

Aspak s' na ndjentej shpírtí pik mërzije
Prëndvera zemrës krejt na që mbërthyer;
Nuk dinim se kjo jetë plot mërije
Të tret, pa shpresë gazi për t' u-kthyer!

Si fletë vjeshte-e tundur prej ç' do ere
Si ças fatbardhësije që s' vjen fare
A por sí nje-êndrë-e shdukur nate vere,

E ndjen, e sheh sí shpresat udhëtare
Të prurín êndje kur-e-kur pa-prítur
Si drítë hêne fushës së zhurítur!

BASH

VENEDIKU

U-shojt shkëlqimí í-yt o Venedík
Qytet krenar nër vepra madhështore,
Që rreth për qark me buzët virgjërore
Të puthte detí-mbret Adríatík.

Pallatet bukurije shëmbëllore
Gjëmonín vallesh rythmí stërmagjík,
Sa purprí-í mveshjes s' ate mbretërore
U-tret një me Luánín t' ênt jetík.

Nga val 'e kaltërt dolle shpes 'e bardhë;
Prej sulmít t' ênt u-tunt një botë-e tërë:
Sí ty kurrkush nuk ndjehej më fatbardhël.

Këmbanat e Shên-Markut sot s' e kanë
Nj' atê tíngllím hyjnor që zjej qytetí
Prej festash dhe kremtímesh an' e mb' anë.

Sot heshtje-e thellë, muret krejt të nxírë —
Lavdíja jote që sí shkumbë detí,
Me drithma tmerrí, sy po hap të gjërë:

Prap detí mos të ka për të përpírë!

PAQJES

O Paqje, Perëndeshë-e adhuruar
Ti popujve q' u bíje lumërínë,
Sí nj' ëngjëll-rojë je që mpron lírínë
Se drejt nga gjíri-í Hyjít kë píkuar.

Për ty dhe Krishtí vojtí-í kryqësuar
Prej zíjes t' a shpëtojë njerëzínë,
T' í thajë lotet, t' í mbjellë dashurínë:
Ballsam t' u shtjerë shpírtve të munduar.

Por sot mí kryq të kanë ty mbërthyer
Me kêrma njerzísh falje-e nder të sjellín
Ty shpírt-kulluar, Zonjë-e pa përlyer.

Sot kupa kur me gjak krejt u-rafshua
Bërtímí-í qarjes tundí dheun e qjellín:
Zbrít, Paqje, thrasín, zbrít se Bota u-shua!..

BKSH

SERENADA E SCHUBERT-IT

I

Kënga íme ndaj nat' herë
Rrugë mer tek ty,
Eja vajzë sy-mësherë
Krah për krah të dy.

II

Qan burrími posht te zallí
Hêna sipër ndrít,
Vajz' e dashur ndaj ty malli
Shteg bën nat' e dít'.

III

Sheh tí zogjtë sí këndojnë
Me një zë qjellor ?
Dhembjën t'íme po vajtojnë
Me tínglím hyjnor.

IV

E kuptojn' ata ç' do vojtje
Një dashnor qe ka.
Shpres' í japín zezës rojtje
Për atë q' e pa.

V

Shpírtí-í yt pra le të dojë
Me një ças sí ky
Zembrat t' ona t' í bashkojë
E lum' ne të dy.

BIBLIOTEKA KOMBËTARE

PARADOKSE

Si njëj plot etje, vêndit që s' i rrihet
Si njëj durim që s' ka, me sa vështron,
Dëshirës tija s' munt se si t' i shtrihet
Por sende dit' për dit' të râ kërkon,
Edh' un' ashtu një grimë s' kam pushuar
Kufi t' i gjej njëj ândjes së pa-shuar.

Gjêsend po, jam pa prâ me t' a kërkuar
Dhe po q' e kam, s' e dua më t' a kem,
Për 'të që zemra shpesh më pat lotuar
S' di më, pse s' i përshtatet shpirtit t' em.
Sa kaq një luft' i hapet vehtes s' ime
M'a bên rrëmuje, copë dhe thërríme.

Një send e dua fort, po prap s' e dua;
Një lule marr e puth, më dhemp për 'të,
Mërzitem fare shpejt — çudi po thua,
E flak si send pa vlerë, si kurrgjê!
Pyetem vet e jo të pakta herë
Tek mua shoh dy veta të përzjerë.

Shoh se përbrênda tjetërkush m' ep urdhër:
Ketê t' a bêsh, më thotë, do-e-mos,
Dhe sa që veshin un' e bêj të shurdhër
S' më le pak prêhje, jetën shoh m' a sos.
Pa dashje bêj një punë që s' e dua
Dhe po s' e bêra, grindje kam me mua.

Her' jam i qettë, vêndit as më tundet
Si dele-e butë shtrihem, êndërronj,
Por një zembratë m' arth e në më mundet
Më ç' do mënyr' armikun t' a lëftonj.
E ndjej se vetja gjyqn' e bên thelluar
Por çastí-i lik, s' më le për t' a zotruar!

E ndjej qysh herë zemrës vrer i derdhet
Shigjeta m' a përshkojnë me plot sulm,
Kur, tjatër herë gazi m' i hap çerdhet
Të lumtur e ndjenj vehten gjer në kulm!
Kur jam në helm, besonj se jam për jetë;
Kur jam në gaz, thom, s' ka më qysh të jetë.

Kur ndodhem në qytet më dhímbet fshatí
Edhè kur jam në fshat, mendoj qytet;
Kur gjendem në të thatët — lum ky fatí,
Me vrap më hapet ênda për në det!
Kudo qendronj gatí jam për të shkuar
Po shkonj, gatí po jam për të qendruar.

Prëndverës mall kam kêngësh harmoníje
Dhe lulesh kur pëqínjvet saj i heth,
At' orë ndjenj dhe ças mellankolíje:
Mendoj si vjeshta vjen edh' i përmbleth!
Më cak kur n' êndrrat jam të lumtërisë
Gjêsend më shtyn nër leqet e mërzisë.

Shpesh dua fíll të dal nër fush' ë kodra

Të bëj fillosofi, nër pyj kur rri,
Por, mëndjen fët e ndronj për foshnjash lodra
Të los, të hidhem si një mituri.
Shoh, sa me mënt të mbahem e te hiqem
Prap me atê që nisa do të piqem.

Në vesh më vjen një tingëll prej së largu
Sikur një zê së thelli më thërret,
Me hov, si sulm i rrebtë thumbash argu
Me msyjtje më qëllon, sikur më vret.
S' di se ç' ane vijn' atô të fshehta zêrra
Që më pyesin ç' bëj edhe ç' po bêra.

Nër qiëj e nër pafundje syt' i shtije,
Më duket sikur s' jam mê përmi dhet,
Po kur mi tok' e shoh të murmen hije
E njoh se jam një krimb me të vërtet,
Në trut' e mij besoj ç' do q' êsht përmblidhet
Por vjen nj' e keqe, „krimbi"-i têrë dridhet!

Së larti si-kur nj' êngjëll dritë-mveshur
Më duart faqet vjen m' i ledhaton,
Kurse një hij' e zezë duke qeshur
Merr vênd, e meje dritën m' a largon.
Në kthjellësi njëmend mezi n' u ndjeve
Me vrik, po sheh, si rè në gjijt' e rêve.

Fuqija e pa dukur që të gjuan
Ç' do çap s' t' a le pa matur ças më ças,

Sheh me pahír nga vêndí qysh të luan
Që tín' asaj pa dashur t' í vetsh pas.
Sheh sí të heq, të shtyn një dor' e fshehtë
Me jetën t' ênde lot, s' të le të qettë.

Marr e veshgoj Ungjíllín e Psallterín
S' gjej faqe mos kujtohet Perëndí,
Por hap do faqe dhe këndoj Voltaire-ín
Mendímet më ndryshohen për çudí:
Një, shoh sí n' hekura të mban qarkuar
Kur tjetrí, mêndjen krejt t' a lè líruar.

Nderonj ç' do fè të rè qysh dhe të vjetër
Moïs e Buddha, dhe Krísht a Mohamet,
Por dhe në qoft se del edhe një tjetër
Aspak të flas për 'të nuk më përket.
Të gjíth të Mírën, dí, që na mësojnë
Por nè, s' dí qysh mësímet u-a ndryshojmë.

I falem Perëndísë ndehur krahtë
Shenjtorët í nderonj përvujtësísht,
Por jo të rrí përpara drrases thatë
Të puth do ngjyra bêrë djallëzísht.
Sepsè me sjelljet e hypokrísísë
S' í lahen dot mëkatet njerëzísë.

Dokush që mban në fè, për 'tê që therret
Munt të më marrë për nj' íkonokllast,
Por mua mêndja kurrë s' do t' më merret

Për një, ç' do punë q' e gjykon më çast.
Njeriu, me mênt' e vet, ç' do që ka çpikur
Esht prap ay që rrenës del i pikur.

Ç' do punë-e mat dhe fajesh unë druhem
Pavdekësín' e shpirtit e çímonj,
Por shoh se sa më tepër që të ruhem
Pa dasht mëkatit prap i jam nër thonj.
E Keqja mi të Mirën êshtë bërë
Një nom që botën e sundon të tërë.

S' ka vênd pa ngrehur tempuj Drejtësisë
S' ka popull këť Hyjeshë që s'e lus,
Por shkojnë kot gjíth faljet e njerzisë
Me që nga lusjet tepra-ajo u-krrus.
Mi kryq i-a kanë trupín sot mbërthyer
Rreth me qirínj të ndezur, gjakrash lyer.

Ç' do kush i thur levdata së Vërtetës —
Që pa një faj përmbys ka râ dëshmor,
Kurse Gënjeshtra breth si mbret i jetës
Dh' asaj të gjíth i bêhen sot therror.
Të parën veç nër mêndje her' e shkojnë
Të dytën gojës kurrë s' e largojnë.

Njeriu sí-i verbër, s' di mê, se nga vete
Dhe për ç' do send, n' i bíje gjurmës pas,
Do shohç se rrugë merr për vojtje jete
Si më ç' do skaje bote gjíth e has.

Sheh se nën' robën purpri q'êsht mbuluar
I skuqin plagë trupi të shkatruar.

Dokush po sa ze ndjehet m' i mësuar
Shpesh her' arrin të bêhet një tiran,
Se shkall' e tij si m' i qytetëruar
Nga të „padijturit" mê larg e mban.
Sa të padijtur s' janë mê të ditur
Sa kurr' atija mêndja s' i ka ndritur.

E di, mësimi prur dobi, hap rrugë
Sa Ruzollimin an' e kênd e njeh,
Por deti qumesht t' jet' e s' pate lugë
Me sy një dit' të bardhë kurrë s' sheh.
Se sa me mundime shpirti, zemër-ftohur
Mê mirë larg qendrô edh' i pa-njohur.

Sa veta s' ikijn' e s' e lenë fshatin
Për jetë mê të shquar në qytet,
Por syresh sa nuk e mallkojnë fatin
Kur bredhin kot, si peshku breth në det;
Qysh fluturat rreth dritës gjith tërhjekur
Gjer bijen posht pa frymë si të mekur.

Të vjen keq fort për popujt krejt e çmêndur
Si bishat që po hahen pa pushim,
Me gjith që dit' për dit' u êsht përmêndur
Nga njerës t' urtë: Paqje dhe Bashkim.
Veçse këtà po flasin kot si n' erë

Kurse për 'tâ këshíllat s' kanë vlerë.

Keq êsht kur kombet luftës í përvíshen
Kur pa mëshírë shpata ze shkreptín;
Por mê te lumtur s' gjen sí-atà që mvíshen
Me robë Mûndësí në ball që prín.
Njeríu nër vedí, bíshë mbet e s' ndrohet
Më dêm të tjetrít rron edhe gëzohet.

Në botë sheh aq míj' e míj' të pasur
Për 'ta një mannë qjellí munt që râ,
Por sa të ngratë s' dergjen buzë-plasur
Shtëpí' e tyre mbetur pa një trâ.
Mí sa kufoma-atà nuk janë ngrítur
Që shpírtín me pahír u-a kanë qítur.

Të dhemp për vojtje mbretí të rëzuar
Qí me fuqín' e tíja bêrí ç' desh,
Por dot s' harronj as bujkun e mjeruar
Kurrkush që qarjet s' doj t' í-a merrte vesh;
Atíj veç lavd edhe kuror' í k' ênda;
Këtíj në brazdë-í thyhet dhe parmênda.

Kushdo përpíqet emrí që t' í mbetet
Massí sa rrojtí botën shtrydhí kot,
Kur pa, se jeta krejt sí dyll' í tretet
Se gjê, sa q' ísh í gjallë s' bêrí dot.
S' díj me c' mënyrë vehten t' a tregojë
Më cak kur pâ se s' ka për 'tê nevojë.

Zili kam per pallate të shëndrisur
Me shtylla t'arta, shkalla gjith mermer,
Por dhe kasollja bukur e stolisur
Më tepër e ndjenj qysh malli i saj më therr.
Atje, paudhësia s' ka munguar;
Këtu, më pak ke drojë për t' u-vduar.

Më k' ënda po, muzik' e njëj sallonit
Nër katër mure tingujt q' i përhap,
Një nxënës munt që s' jam nga t' Apollonit
Gjykimin t' em të plottë që t' a jap,
Por për një zë të fyellit, shpesh tretem
Kur pylli krejt gjëmon, sa vëndit mbetem.

Vërtet s' ka gjë më-e shtrënjtë se shëndeti
Fytyra rreze gazi kur të çpall,
Ay, burim ësht jete dhe ç' do mjeti
Dëshirën për ç' do veprë që t' a ngjall.
Por dhe mjerimi herë na ka hije
Diku na sjell në njohje Perëndije.

Natyra ka si madhështi dhe hije
Veç kur heth syt në bashkësin' e saj,
Por, po sa-e merr ç' do send anas, dij-e
Të metta do t' i gjesh dhe ku s' ka faj.
Se kurrë s' munt të jetë gjë-e mbaruar
Në qoft se s' është ndryshe gjë krijuar!

Dhe Toka, ditët na mi 'të q' i shkojmë

Një jetë t' ameshuar s' trashëgon
Në, shpínën í-a gërvishím ne të rrojmë
Dh' ajo sí ne do tretet shpejt a von.
Sí nga kurrgjê q' u lint, u-bê krijesë
Te tjerë për t' í ngjízur do të vdesë.

Një libër hap me talljet e Mollière-ít
Sheh jeta merret gjíth me qesendí,
Pastaj marr një të Dante Alighierí-t
Parrajsa, Ferrí janë komedí.
Aspak mê s' dí, sa ka kjo jetë vlerë
Kur dhe përtej ç' do shpresë t' êsht'e prerë!

Nër djaj edh' êngjej êndje tepër keshe
Aty në mest t' u ndodhesha sí mík,
Me 'ta më një tryezë bashk të jeshe
T' í-a shoh atíj ket' êndrë q' e ka çpík.
Të gjíth këtâ në janë trup edh' eshtra
A po mos janë fare do gënjeshtra.

Të dhímbet kur e ndjen sí shkon kjo jetë
Kur s' dí se ç' do të bêhesh po të vdeç;
Një mì, një ka, një zog munt shelg a fletë
Në qjell do ngjítesh a në Ferr do zbreç,
Por sa të bíjesh preje nër dyshíme
Pluhur e hî mê mír' e pa mundíme!

NGJYRA YLBERI

BKSH

ВКSH

MIR' SE NA ERDHE PRÊNDVERE!

Mír' se na erdhe përsëri
E bukura prêndverë,
Me rreze t'arta, me stolí
Me qiell të rímt'e bukurí
Te nà, sí vjen nga herë.

Stolísur vjen sí Nuse-e rè
Me buzët sí qershíja,
Me flokët hapur sí nje rè
Që kur mbulon ç'do kênd mí dhe
Ringjallet njerëzija.

Sí Zanë qíellí zbret me mall
E bardhë, sy-qjellore,
Të gjítha rreth í çel, í ngjall
Dhe shpresë jete tí na çpall
Me puthjet êngjëllore.

E qeshur vjen me gjíret plot
Na mbush me gjíth të mírat;
Me gas të presím mot për mot
Pa ty në botë s' rrojmë dot
Se tí na ndes dëshírat.

Mí krerët t'ona lule shkunt
Të kuqe dhe bardhoshe;
Tej zogu kêngësh erën tunt

Dhe flùtura po lot sa munt
Me shoqet pikaloshe.

Prêndverë-e bukur sa po vjen
Prur kêngë-edhe dëfríme,
Të lodhur dímrít në na gjen
Me duart plot tí na çpërblen
Me míj'e míj' gëzíme.

Mir'se-erdhe pra, thom përsëri
O bíj' e bukur Mbretí,
Me tufa lulesh plot magjí
Me gjínjt'e tu plot dashurí
Me frym'e mall shëndetí!



BKSH

PAMJE

Që lart nga qjellí
në hapësìt, sí lêmsh í zjartë
u-rëkëllye djellí
kur perëndoj,
Por mb'udhë, maje shkêmbi të njej malí —
takòj të jetë malí-í lartë,
me që dot hovín nuk'e ndalí
keq u-përpoq, mënt kryet í dërmoj !
Një gjak të kuq zu plagës hodhí,
u-skuqnë-edh' ujrat edhe toka
u-skuqnë rreth e retë !
Por mêntë kur í mblodhí
kur pa q'e dhímpte koka
plot helm u-shduk e shkavi tatëpjetë !

Në píkë të vrapímit
í rodhí gjaku shumë ;
fytyr'e tíj u-skuq sí prushí,
sadô në det e lau sa mundí
me gjetht' e pyjeve q'u-fshíh,
dhe têrë natën mbet pa gjumë
dhe prej dëshprímit
sysh derthte lot sí kokra rushí ;
se kur përtej u-duk prap në mëngjes —
gjer sa u-gdhíh —
s'í kísh pushuar !

Dhe po sa dollí kryet shkundí
prej dhembjes së tmeruar !
Sí gjaku mirë s'e kísh lênë
í pati lídhur faqet me një bres
dhe brezí lyer që me gjak -
një bres í bardhë fíjesh, sí ç'do fíje lesh,
se lesh nuk ísh aspak
por íshín fasha resh
fytyrës q'í kísh vênë !

* * *

Sí hej zu gjaku shpërkêndítej nga që rodhí !
U-skuqnë prap edh'ujrat edhe toka
u-skuqnë rreth e retë ;
tej kresht'e màleve me dborë shtruar
dhe bredhat majravet - q'u dukshín sí burbuqe,
u-lyen ngjyrë trëndafílí ;
dhe detí-í têrë-u bê pasqyr'e kuqe :
í larë që me gjak sícílí,
síkùr prej dore magjístarí t'íshín ndruar !

. . . . . .

Mê von kur pâ se dhembjet í pushuan
shpejt fashat tej í hodhí,
kur pâ se syt' í u-kthjelluan
dhe-e ndjevi vehten mê të lehtë,
zu mêntë prap í mblodhí
kur pâ se mê s'e dhímpte koka :
me hov, plot gas u-hoth më qjell përpjetë !

YLBERI

Tej nga reja që rri grumbull
Del ylberi mi liqen,
Më dysh hapur, gjysmë rrumbull
Brez me ngjyra që shkëlqen.

Ah! sa bukur thotë Pjetri
Shih se ç'ngjyra plot shkëlqim,
— I thosh vehtes, jo njëj tjetri —
Gjê çudije plot pëlqim.

Prush e kuqja, zjar po thua
Mezi-i kaltërt mê s'ka shok,
Edh' e verdha si limua;
Sa sicila syt' t' i rrok.

Pa të vete me një pjatë
Drejt atje mu ndë liqent,
Të mvjeth pak nga-atê dhuratë
Aq e pasur që m' u-gjent!

Dhe më çast po rend djaloshi
Pas ylberit që po doj,
Ujin dy tri her'e shoshi:
Por o Zot, ku dreq më shkoj?

Pa shih! bishti-i tij i bukur
Që po lagej në liqent,

Pranë shelgut, si m' ish dukur
Syt m'a panë, si s'u-gjent ?

Ah, o Zot sa jam i ngratë
Të ze besë se do mbleth
Un' ylberin me një pjatë
Të marr soje-a po të mvjeth !...

Kjo pra qênka dhe në jetë,
Gjith me ngjyra dhe stoli,
Aqë sende plot të mettë
Syt t' i rejin pa dobi !

BKSH

STINAT

Çpallet dita
Tretet nata,
Tfaqet drita;
Sgjohet pata.

Hapet qjelli
Çohet reja,
Bije djelli;
Del kopeja.

Mvishet shkêmbi
Çilen ferrat,
Ritet gjêmbi;
Mahen shqerrat.

Lihen gunat
Thuret mali,
Lozin çunat;
Hidhet kali,

Ndrit liqeni
Lahet rosa,
Turret qeni:
Mprehet kosa.

Skuqen thanat
Piqet gruri,

Shkunden manat ;
Çvíshet drurí.

Vílet rrushí
Mverdhet fleta,
Drídhet bushí;
Pshtíllet jeta.

Thahet barí
Therren berra,
Ndízet zjarí ;
Píhet vera.

Fryn murllaní
Zbardhet bregu,
Dergjet staní...
Zíhet shtegu.

Mbyllet porta
Çelet ênda,
Zbràzen shporta ;
Thyhet pênda !...

◁○○○▷

Pse sí brumbull breth, kërkon
Jetës shíjen që t'í-a gjesh.

Kur këtu e kur atje
Del e shdukesh sí sklífter,
Shkoj Qershorí tí mê s' je
Síkur bíje drejt në ferr.

Ze vjen vjeshta brym' e shí
Kohë-e dímrít me cíngrím,
Tí gjíth vet' o zog fatzî
E shkon jetën në harrím.

Shíh bílbílín një trup-mî
Dëllëndyshen sy-gjarprush,
Dhe thëllënzën ngjyrë-hî;
Me folenë sí gjíthkush.

Ndo lavroshen krahë-shpejt
Shkurtë-e turtull a po ç' dô,
Ndo mëllínjën kêmbë-drejt;
Palë, palë-í sheh kurdo.

Ve tí pjell e ve tí s' ke
Rron e lírë-e pa kujdes,
Zogjt' e tû se ku í le
As të hyn ndopak në thes.

S' të ka híje qyqe-aspak

Kur se mëndjen nuk' e shtron,
Çdo gjë-e gjallë që ka gjak
Mbi dhet posht'e vetëm s'rron.

Veç në qoft se ndoj' mëkat,
Farës s'ate i ke çpërblim,
Zog i mjerë n'e paske fat
T'a shkosh jetën në mallkim,

Rro pra qyqe nd'arrati
Se ky qênka fati-i yt,
Gjith pa shok e pa shtëpi
Gjith me vaje-e lot në syt!

BKSH

QYQJA

Gjíthë shpesët me folè
Gjíthë bota me shtëpí,
Vetëm qyqja mbet sí qé;
Zog í shkretë-edhe fatzí.

Sí vjen Príllí nís këndon
Pyll më pyll e gjeth më gjeth,
Këngë-e vaje gjíth lëshon;
Tunden malet lís e breth.

Me zjar këngës kur ja shtron
Zemrës mallín na e nxjer,
Pyllí, kodra rreth gjëmon
Radhas *kuku* kur í-a mer.

Shum' í k'ênda kur ja thur
Sí kasnec í lajmes ré,
Veç që zemrën e ka gur;
Rron sí murgu, s'ka folé.

— Për se qyqe nuk gjen shok
Pse-arratísesh brî më brî,
Pse, s'afrohesh të jesh tok
Síç' e la një Perëndí.

Për se qyqe s'më dëgjon
Fjalës s'eme s' í ven vesh,

VEGIM PERENDIMI

Me sy habíje shoh tej largësírën
Dhe rehtë ndënë vetull sí dremítín,
Shoh rrezet qysh e prekín errësírën
Me míjrat shtíjza syresh që reshqítín.

I lodhur dal nga dal po shduket djellí
Síkur díkush që posht e heq pa reshtur;
Porsí një líbr' í math mbyll faqet qjellí
Me pamjet madhështís' së tíj të heshtur.

Dhe híje-e murme vjen me fletët hapur
Me hovín e pa prêhur t' ameshímít,
Nër thonjt' e saja shpírtín duk' m' a kapur
Sí bísha pa kurrfare përdëllímít.

Del hêna me syt' e saj dërptonjës
Dhe me vështrím të thellë magjístarí,
Ç' do send e namatís me hov qëllonjës:
Më deh me plot mënyra gënjeshtarí.

Ndë heshtje dhe nër êndra bote së pa-prekur
E çanj mërgímn' e ndjenjave të míja,
Me mêndjen tej pafundjen duk' e ndjekur;
Veshgoj ç' do hyll t' a shkoj mí vígje-e víja.

Në luftë të pa reshtur jam me vehten
Gjêsend kërkonj t' í prur për t' a kënaqur

Por shoh fuqít' e míja sí po treten
Síkur pa shpresë prap për të m' u çfaqur!...
. . . . . .

Nís endet díta prej plehures zezë
Sa natës gjurmë fare mê s' í mbetet,
Mí tokë, gjêrë shtríhet një tryezë
Ku dríta derdhet posht sí ar që tretet.

I dehur jam prej bukuris' së dítës
Prej kaltërsis' së qjellít të kulluar,
Q' e kqyr-sí ç' do send me sy shëtítës
Plot etje të njëj êndjes së pa shuar.

E shoh sí derdhet rrezja magjístare
Në faqet sí më puth me mall dashtnorí,
Síkur që lart një dorë shpëtímtare
M' a fal së rísh atê që dje m' a morí!

BKSH

Natyra êsht një líbr' í hapur për këdô
që ka pak êndje t' a leçítj' atê,
se na mëson do sende me themel
e s' na tregon do pralla të kujtdô
përpara që na del.
Sa gjêrra nuk vështron kur syt' í heth më 'tê:
e dí se qjellí êsht një hapësí
që s' ka fílles' as fund,
se fundín po kurrkush s' e dí
sí dhe fíllesën as nuk mund
sadô në pate mêndje-gjêrësí
t' a gjesh gjêkund.
Fílles" e fund, të dísh, në dô, për 'to
mëso pra, se të dyja janë një këtô;
se qjellí s' êsht sí një pullàs
atje ku syrí lart po sheh
êsht një pafundje, thellësí, kudo q' e has
që kurr' as mas' as anë s' ka;
për aq sa díja jonë njeh
dhe mêndja jon' e hâ.
Se hyjt, kandíle janë, tha díkush
e ç' do njerí se ka nga një
që ndízet kur se línt
dhe shuhet po sa vdes!
Një prallë që nuk e beson kurrkush
e një gënjeshtrë që s' të bínt!
Kandíle pra në janë-e kush í ndes

këtë nuk na e thot' asnjë
veç ay që ka mungesë trush,
se, sa për orë linden, vdesin përmi dhè
t'i ndezë-a po t'i shuaj ' Perëndija vet
thom, besa, se s'ka ngè
dhe mêndja dot s' na e pret!
Se, libri na tregon këtê mësim:
ç'do hyll në qjell që ndrit
i vogël qoft a po i math
ka jetë nga jeta pa shtërrim;
shpesh botë rron në 'të
me frym' edhe me zê;
si tokë, në pafundje ka një vath
ku munt të levizë pa pengim
e mos përpiqet me kurrgjê;
ashtu që ka edhè atje
qysh net' ashtu dhe dit'
që ndrojnë radhas e një nga një;
dhe djellra ka q'i ndrit, q'i ngrohn
ashtu qysh bêhet e mi dhè!
dhe njëri tjetrit larg êsht gjithashtu
sa që nga hyjt e gjer mbi dhet këtu,
ç'do hyll një fat ka q'e drejton —
se Krijetari ka fuqi
ç'do gjê t'a verë në regull si di;
një lindet edhe rron, tjatër vdes edhe shkon
përjetësin' asnjê s'e trashëgon!
Se-edhe kjo tokë që gjallojmë nè
êsht një krijesë gjith si têr' ata

q' í shohím grumbull përmí na ;
sí lêmsh në hapësí gjíth rrotull vjen
mí ujët s' rrí ; por ujët rrí mí 'tê
kush thotë ndryshe na gënjen !

Po t' íshím lart e nè
t' í híthním syt q' aty
do të vështroním dheun se
një hyll êsht edhe ky
e gjíth ato sundíme ka ;
se Perëndija sí ç'na bêrí nà
í zotí qè t' í bêj' e têr' atà —
përveç sícilín me një ndryshím
sí pas Kríjesës nalt q'í urdhëron.
Kësaj së têrë bote që s' ka nísje-e mbarím
pa prâ që levís e rrotullon :
í thomí me një fjalë : Ruzollím !

BKH

SHI PO BIJE!

(Adaptim)

Shí po bíje! Le të bjerë!
Kopsht, lendínë zun'e thahen
Lulet epur sa po mbahen
Sí të mjerë.

Shí po bíje! Le të bjerë!
Arat, vreshtat çelen, ríten
Pjergull, kungull gardhít ngjiten
Gaz í ndjerë.

Shí po bíje! Le të bjerë!
Po pas shíut ze qesh qjellí
Dhe me rrezet rehtë djellí:
Do t'í çjerë!

ВКСП

LULJA E KEPUTUR

E mjera lule të këputa
Pa pik mëshire-e dhempshuri,
As unë s'di pse kaq u-nguta
Që nuk t'u-solla si njerì.

Nga shoqet rrebtë kur të ndava
T'afrova plot fisnikëri,
T'a morra erën e mënt qava
Në ty kur pashë-aq bukuri.

Kur vura dorë-e mjera lule
Nga shoqet egër të të ndaj,
Tin' as u-hoqe dh'as u-sule:
Po mbete vêndit e pa faj.

I dehur bukurisë s'ate
Të vola gjith me mallëngjim,
Aq sa mundimi kot s'më vate
Me ty të mburret gjiri-i im.

Nër shoqet rinje shtat-krenare
Me rrezet losnje gjirit t'ênd,
Të ndrisnin ngjyrat si ca zjare
Që prurin dritë më ç'do kênd.

Me hiret ndjenjat m' i dëfreve
Veç un' u solla si shpirt-lik,

Kur nër gishtrinjt'e mij u-ndjeve
E pè, sa rrallë gjen një mik.

Nuk pate zê që të më lutesh
Por as me thumb të më pickosh,
Se dorës mirë ti s' i tutesh
Në 'të një mik po të shikosh.

Me pa mëshirë ty t' u-solla:
Të drodha para syvet mij
Q'as nuk të rita dh' as të mbolla
Përdhè pa dhimpsur të të shkrij.

Andej këtej keq e shpërndarë
T'u fik ç' do mis i hirit t' ênd,
M'u-duk se jam një mêntsh i marrë
Pse nuk të lashë ty më vênd.

E mjera lule të çkëputa
Prej gjirit t'em pa dhempshuri,
As vetë s'di pse kaq u-nguta:
Dhe nuk t' u-solla si njeri!

NJE UDHETIM!...

Qysh fluturími-i njëj shqíponjës erën q'e përçan
po gjíthashtù mer rrugën dhe mêndja e-íme
dhe ngjítet lark me të kërkuar
t' arijë nër të thella panjoftíme
të hapësirës së pa fund,
tek breth pa prâ me t'a veshguar
largímin njërín tjetrít që na ndan
pa mos u-ndalur asgjêkund.

Por me t' u-arratísur —
porsí nj' aníje q' arratíset valavet e shtyrë
prej ere detí së tërbuar,
në gjíjt' e rêve râ ! Edhe sí një këpucëgrísur
që vênd e derë s' le pa shkelur dhe pa hyrë,
u-loth, u-shtryth ne mjegullt e ngatruar
sa s'díjtí të dalë trapít të tmeruar!

Mjaft kohë humbí duke bredhur
sa, preje do të bínte nër gjëmímet
e rêve që përpíqeshín me bumbullím ;
vështronte qysh rrufèt'e dala nga shkreptímet
po derdheshín gjíth duk'u-sulur
sí shpata zjarrí që kryqësohen për luftím
drejt trupít tokës majat thellë duk' í-a ngulur !

Po prap një rrugë-ajo pat gjetur...
por me të dalur s'dí sí shket

sepsè u-rungullís e râ në det !
Me t' a përpjekur ujët, me fuqín'e tretur
një pellg u-hap edh' e përpíu ;
qysh hej rreth píka duke hedhur
që bíjnín prap sí lote shíu
dhe drejt në fund arríjti duk' u-dredhur !

Aty keq fort e dëshpëruar
fílloj të bredhë përsëri
të dalë kurthít ku pat rênë ;
prap rrugë doj për të shpëtuar
së rísh të vej' atje :
të zêrë vêndín tek pat qênë !
Veç se në t' erët s' díj ku që
se fundí-í detít ísh í zí
mê-í zí se nata kur s' ka hênë
me qjell pa hyj e mveshur rè.
Pâ, míjra píshq gatí me gojën hapur
kur í përçanín ujrat, t' urët për të ngrênë,
gjíthmon në luftë sí përmí dhè,
sí, shoqí shokun doj sícílí për t' a kapur :
ushqím í çasít për t' í qênë !

I bêrí ballë mjaft kësaj skëterre
mezì me míj mundíme faqes detít dollí !
Dhe kur andej këtej po síllej
porsí një pêndë-e hedhur ere,
're vurí marrësía se ç' í polli
për t' í veshguar skajet e njëj bote !

Pâ, valat qysh e puthnín me t'u-tallur
nër thonj, qysh egërsíra gjahun duk' e përkëdhelur;
kur, maje kreshtës duk' e ngrítur
me mveshje shkumbe sí argjênd í derdhur,
kur, pa mëshírë gjíth me hov nër funde duk'e zbrítur
dhe palash ujít rímtë, pâ, sesí mbështíllej!
shpesh díamande ballín í-a kurorëzonín
me dorëplotësí të hedhur prej së tmertës sqote!
Buçímí-í njëj muzike s'egër fort í víj në veshë
dhe valle fandastike pâ, duk'u-shpërdredhur
me brítje-e klíthma q'e nguronín
kur në t'u-mundur valat íshín duk'u-hedhur!
Pa pík fuqí për t'í përballur
për t'u-larguar nga-aqë tmere;
po gjíth duke hedhur sysh margarítaresh lotte
nga gjírí-í detít q'í pat vjelur,
q'í bíjnín por sí píkat njëj qírírít tretur!
Plot fríke rríj sí dyll' e mverdhur
dëshmor e lodrë në këtê aq të tërbuar meshë
të Ferrít zí ku kêmba s'í pat shkelur
veç me një shpresë mbetur
qysh munt t'í dalë zot kësaj pík here!

Në píkë të mëngjezít kur se ndríj agímí
dhe tfaqej me fytyr' e petka në të kuqe-e në të bardhë
dhe prij me qerren tíja t'artë Febí Bukuroshí,
sapo kísh marrë vehten prej këtij vegímí
pâ, se pëlhur'e mjegullës që çjerë!

Në gjit e dheut si vajzë-e urtë flinte deti —
passi furit'i shkuan e zëmrimi,
plot ândje buzëqeshte-e dhëmbët an'e kênd i-u zbardhë
massi dhe ujrat mjaft i siti edh'i shoshi!
dhe pa vonuar, dita fletët nis t'i hapë
me një të drithmë t'erës hollë, të pa ndjerë!

Kur djelli me gishtrinjt'e hapur
si patërshana po dërptonte kubën tej qjellore
dhe kryet me nga dal filloj t'i nxjerë,
sikùr prej fundesh deti syt'i çelte duk'i larë
me hov për fyti Terrin e kish kapur
edhè mi 'tê po ecte me plot madhështi hyjnore!

Tej rêtë, ylbere si kurorë mbreti
për qark i çonin plot shkëlqimi —
kur njëra tjetrën ishin duk'e ngarë
me ngjyra shum'e plot pëlqimi,
dhe faqe-e ujit rudha rudha hollë dridhej —
e Qênura me të Paqênurën tek pasqyrohen
sa, bukuria-e Botës në 'tê përmblidhej!

Përgjonte zêrra kêngësh ëngjëllore
nër qiej e dete si jehonin
sikùr të dalur prej njëj bote krejt prallore
me tinguj harmonije çonin
tekdo që shihje, hymne lavdërimi:
kujton se gjithëçka nërmjet po përpushtohen.

Kurse-era me një fryjtje ledhatare
pa reshtur gjíth í-a puthte kurmín levarash,
e morrí vehten e pâ
se s'qênka pun' e lehtë fare —
fuqíja kur s' t' a hâ,
kësíj mënyre botën që t' a çash !

BKSH

FYELLI

Kujtim Dëshirës së pa shuar të Naim Frasherit për Bagëtin' e Bujqësin' e Shqipërisë.

O fyell, t' adhuronj me mall e besë
Se bashk me zêrin t' ênd hyjnor jam rítur
Që kur se njoha djalëri,
Se tí në shpírtin t' em ke derdhur vesë
Në kulme gazí ndjenjat duk' m' í ngrítur
Me një të rrallë dhempshurí.

Me tyn' e ndjeva mallín e pa-shuar
Të dashuris' së tokës arbënore
Q' e kam për díta n' ênderrím,
Me tíngllín t' ênd, kujtími-í kohës shkuar
Nër mênt më shkon me plot flladî verore
Dhe me të thellë ngazëllím.

Tí kur í a mbush me plot e kur í-a thua
Sa zêrrat ven' e vijnë palë-palë
Sí valle vargut ëngjëllor,
Sí shok në zê ke kodr' e mal e prrua
Porsí prej goje Zane t' jet' í dalë
Prej njëj pallatít madhështor.

Qysh drít' e hyllít shket mí rreze hêne
Me faqet e líqenít duk' u-çmallur
Me dríthma droje sí dashtnor,
Dhe verbí í yt, lajmtar í njëj së Thêne

Të Bukurës së Dheut me zê të çpallur
Blaton nër nè fullim veror.

Kursè prëndvera gjiret nís t'í çelë
Dhe me t'í hapur kraht'e saj të gjërë
Na jep fuqí dhe hír qiellor,
Dhe tí, kur gishtí gamat nís t'í shkelë
I jep të rè fytyrë botës têrë:
Krijon rreth nesh një kor gazmor.

Bariu me ty nër bjeshkat del e çmallet
Me vaje tíngllesh, vaje plot magjije,
Ç'do zjarr të zemrës që j'a tret,
Me ty të rínjtë radhas heqín vallet
Të shtyrë prej së shênjtës dashurije
Në gjínjt'e saj gjíthmon q'í pret.

Síkundër gjethet hollë drídhen n'erë
Aq'sa nga dríthm'e tyre kêngë çpallen
Duke trajtuar harmoní,
Dhe zêrín t'ênd kushdò q'e ndjen për herë
Kujtímet e harruar prap í ngjallen
Mu sí nj'e qjelltë symfoní.

Del bujku ngul parmëndën, shpínë-thyer
A korr kallínjt'e pjekur bukë-prurës
Q'as vetë s'dí për kë dërsín,
Me ty ç'do brêng' í shkon duk'u-shdëfryer,
Síkundr' í shkon edh' etja n' ujt' e gurrës
Q' e kap me grusht edh' e përpín.

Dhe prindrit t' an' e kohës së larguar
Me ty në brest; e shpatë në përdornin
J'a mbushnin kêngës plot me zjar,
Nër luftra trimëri duk' u-flakruar
Gjithmon kurorë Mundjeje të korrnin
Si ç' korrte Leka legjendar.

Plot ândje dhe Minerva Perëndesha
Me tyn' e shkonte kohën nër dëfrime
Lart tek Olympi shkreptimtar,
Dhe Nymfat rreth e rrotull si Hyllesha
Me valle çap-rythmike dhe kërcime
Ndërsenin Bakhun zilitqar.

Virgjili, mjeshtër kêngëtar me famë
Nër shekuj aq' të tjer' e qysh Mozarti
Prej teje bêjtin shênjt alltar;
Me tyn' ëndrrijtnë popuj q' as i pamë
T' ushqyer idealesh që së larti:
Prej njëj Burimit shpëtimtar.

Sadô të tjerë sot t' a zunë rendin
Si shênj' e rè të njëj qytetërimi
Që s' njeh në botë kundërshtar,
Por vjershetorët hymne ty prap t' endin
Se mi të gjith' prap ti plot forcë-trimi
Qendron, o fyell magjistar!

ÂNDJE VERORE

Pyll í gjelbër madhështor
Me plot ênda, bukurí,
Tí me hirín t' ênt qjellor
M'a mbush zemrën me magjí.

Tempull zânash síkur je
Ku me drojë kushdo hyn,
Rreth shënjtorë síkur ke ;
Kêngë lutjesh erë fryn.

Prej së thellít çon një zê
Kur po fletët brí më brí
Palë palë-e një nga një
Puthen, píqen me-ëmbëlsí.

Kryeverës kur je mvesh
Por sí Nuse me stolí,
Lule-e fletë buzëqesh
Gjíth me ngjyra, gjíth rísí.

Nëpër degët plot me gjeth
Zogu kêngës kur í a thur
Mjaltë gojës heth e mbleth —
Prej habítjes mbetesh „gur"!

Blegtoreshë dhe barî
Nër kullotat bêjnë shtrat,

Rreth e rrotull dhen e dhí
Ne 'tâ shohín mêmë-e at.

Sa të k 'ênda kur gjëmon
Zêrí í fyellít plot me mall;
Vaje-e kêngë kur lëshon
Dhe të vdekurít í ngjall.

Plot këmbora kur tíngllon
Kur se dashí porsí mbret,
Kryelartë shkel e shkon
Dhe shëtít pallatn' e vet.

Tek burími rreth me bar
Buzës ujít-ëngjërví,
Rrí bilbilí magjístar
Djatht' e mëngjër syt' kur pí.

Majë lísít degë-plot
Vjen shqíponja bên folè,
Posht arrushja breth sí zot
Syrín gjahut nuk e ngreh.

Shíh sorkadhja se sí shkel
Síkur vêndí mê s' e mban,
Ja dhe ndrerí mezí del
Per 'të pylli është stan.

Ují-í prroíít an'e-kênd
Gur mí gur sí gjarpër shket,

Pikat derdhen si êrgjênd
Tingëll zêrash êmbël qet.

Kêngë-e valle pa pushim
Gjith në dasmë je pa prâ,
Bukuria s' ka mbarim
Pa ty bota shije s' ka.

Shpirti qjejsh më fluturon
Kur t' i shoh ato stoli,
Gaz në zemrët më kullon
Têrë trupi merr fuqi.

Tek ty zemrën kur e hap
Si nj' Ungjillit q' e veshgoj,
Ku ve kêmbë, bêj një çap
Ndjej se dhembjet i shëroj.

Kur ty pyll të shkoj nër mênt
Më kap malli të të shoh,
Të jem pranë gjirit t' ênt
Me 'të gjirin t'em t' a ngroh.

Pyll i dashur, pyll vëllà
Sa dëshirë për ty s' ndjej,
Pa ty jeta shije s' ka ;
Shok të zemrës si ty s' gjej.

Malli jyt e malli-i em
Miq të njohur që të dy,

Po sa píqen, çmallen. them
Sí dy zemra, sí dy sy.

Pyll të lutem kur të shkoj
Hap-e gjírín e me merr,
Se sí foshnjë t' ëndërroj
Kur kujtimí-í yt me therr.

Tek ty prêhjen dí q' e gjej
Se në jetë bêra bè,
Mí varr qarjet mos t' í ndjej
Shpírtín trupít kur t' a lè!

BKSH

VAJE E PYLLIT

Pyll i mjerë ç' ke qan
Prej krahnorit që gulçon,
Mos do shokve zi u mban
Që po dridhesh e gjëmon ?

Kryet ul si grua-e vè
Me fytyrën pa gazmend
Ç' ke që kraht' i le përdhè:
Si kur lutesh për gjësend ?

Prej ç' do flete lot lëshon
Vetull-vrenjt si qjell me rè,
Helmi buzës të pikon
Si-kur gazi krejt t' u prè.

Ty thëllimi nuk të tremp
Dhe shtërgata s' të përgjunj,
As rrufeja ty s' të shemp
Dhe n' u-thafshin disa hunj.

Verës vapa shpesh të than
Dimri degët keq t' i ngrin,
Por ti s' tutesh ç' do që ngjan
Dhe kur breshri të përfshin.

Munt që vjeshta të tmerron
A po bryma se t' u shtrih,

Dhe se mjegull të mbulon
E të le pa pik stolí?

Shoh këtô se s'janë gjê
Një send tjetër ty të vdír,
Plagë jete që t'u bê
Q'í fal shpírtín me pahír.

T'a dí dhembjen, pyll që ndjen
Për të keqen që të gjet,
Prej pikllímit që tí zjen
Për armíkun që të vret.

Se druvarí zemër-lík
Hedhur *bishën* për mí krah,
Të bên copë-edhe të fík
Për një dru e për një tra.

Kur sëpata copra therr
Thelat bíjen posht pa zê,
Bjeshkë-e kodrë hyn në tmerr:
Dorë ndíhme s't'ep as një.

E ndjej gjêmën që të gjet
Kurmí-í prerë lot sí derth,
Malí zjen, gjëmon, gërthet
Më të drithmë që të mverth.

Por ti fajin e ke vet
U-gënjeve dhelpërisht,
Sepse *bishës* që të vret:
Pyll, ti vet i fale bisht

BKSH

MERZI VJESHTE...

U-mverth pyllí, u-shkretua
Mvarren fletët vêthesh vargje,
Shelgjet derdhín lotesh krua
Degët epur argje, argje.
Tek líqení lahet djellí
Thyer copra nga shtërgata;
Zallít plepat, sheh, tek qiellí
Majat ngulur sí ca shpata.
Gjurmë shtërgu s'ka mê sipër...
Zî mban kopshtí, treten híjet
Mí stolít' e fushës, sí për
Vdekje bryma natën shtríhet.
Me plot turpít vírgjëreshe
Rêsh del hêna vajzë-mplakur,
Pa pík zjar sí mall murgeshe
Buzë-thart' e sy-përgjakur.
Era fryn me vërshëllíme
Fletët ashpër poshtë ndíqen,
Zê muzike plot kuptíme:
Sa që shduken prap mê s' píqen.
Pellgjet ují prej thëllímít
Mblídhen, hapen pa pushuar,
Sí dhe zoqtë kur cíngrímít
Shkundín kraht' e dríthtëruar.
Reth natyra rrí sy-mvrenjtur;
Kresht' e malít me rê lídhur,
Sí një plakë faqej-ênjtur

Prej së ftohtit duk' u-dridhur.
Lisat tinës nërmjet flasin
Si do pleq fytyrë-ngrysur,
Kur her' eshtrat u kërcasin
Tundin kryet të përmbysur.
Kodra mbet e vè stolije
Si-kur shkoj nën' presë palle,
Me zê qarjesh vïolije
N' erë lozin ferrat valle.
Kurmí-í pyllit sqotës tundet
Kur çel gjuhët saj të mprehta,
Katallàn gjithmon që mundet
Me fërtym' e me shigjeta.
Hij' e rêndë, hij' e murme
I ndeh kraht' e saj të butë,
E ze dritën si një mur me
Dyer burgu që than trutë.
Dridhen hyjtë nëpër bisqe
Gjith të trêmbur syt' u çohen;
Uji-í prrojit brisqe brisqe
Erës faqet, sheh, sí-í ndrohen.
Trëndafili kuspull mbledhur
Mban syt' ulur porsí murgu,
Gjith pret zijen për t' a hedhur:
Pret të dalë muresh burgu.
Majë gjêmbit rrí bilbili
S' lot as tundet si nga herë,
Qan ay, qan trëndafili
Qajnë rrotull zoqt' e tjerë.

Sorrat, korbët ngjyrë nate
Me zê kobe rahin lisat,
Dhe thëllênza jetë-ngrate
Gjuan krimba nëpër plisat.
U ngjir fyelli së ftohti
Lehjes s' ujkut dridhet stani,
Mes kasolles vet si zoti
Hyn e del kur fryn murrani.
Më gjunj plaka, më dysh thyer
Qysh ajo, qysh vatra nj' akull,
Dy thingjij për t' i ndërsyer
E mfryn gojën e bên shakull.
Mi shtrat vajza dyll' e verdhë
Me gishtrinjt si hej t' holluar,
Çasn' e fundit pret t' a derdhë
Nga kufom' e saj e shuar.
Me grusht jetës i ra vjeshta
Mike-e vdirjes e vështirë,
Kur prej gjirit saj qet heshta
Vret si vdekja pa mëshirë.
Orë tmerri, ças mërzije
Barrë plumbi, sa s' merr frymë
S' i gjen dalje murmes hije
Që vjen valë, bêhet rymë.
Sheh mendimet trush si nguten
Ndjen si shkasin me vrap grime,
Qysh do gurrë kur çkëputen
Që prej maje shkarëzime.

Shpírtí dergjet dyer-mçelur
S' ka kuxím për t' u-shdëfryer,
Kur sheh vdekja qysh ka vjelur
Sa që dora s' í pat kryer!

BKSH

TRANDAFILI

Që kur në botë lulet kanë jetë
Veç unë jam që mbretëroj mí 'tô,
Se un' jam Lulja-mbret!
Një tjatër vêndín t' em as munt t' a ketë
Se gjíret, gjêrë kur í hap kudô
Me gaz kushdô më pret.

Që me t' u-gdhírë díta prëndverake
Dhe gjer sa qesh një djellë díměror
Me mall gjíthkush më çík,
Që prej kasolles s' ult' e varfanjake
Sí dhe gjer te pallatí mbretëror
Të gjíth më kanë mík.

Ç' do rreze, qesh në gjínjt' e míj kur derdhet;
Ç' do píkë vese-e bêj margarítar,
Shpall drít' e gaz hírplot,
Kur vjeshtës, pyll e fushë nís e mverdhet
Dhe çvíshet robës shelgu qamatar
Prap unë mbetem zot.

Un' jam ay që çfaqem plot magjíje!
Stolí kam gjyrat botën q' e ndërsen
Stolí që syt' í-a merr;
S' jam qysh ylberí qjejsh kur del sí híje
Veç për një ças, me gjyrat syt' q' í ren
Sí dh' avull shpejt q' u-t' err.

Gjíthmon me mua Bukuría mburret
Stolí pa shêmbëll jam për ç' do krahnor;
Vesonj ç' do zjar që djek,
Nuk trêmbem as njëj dore kur më turret
Sepsè te ç' do njerí kam një dashtnor:
Me nder kushdo më prek.

Me mua rruga Mûndësvet u shtrohet;
Dashtnorve mallín zemrës un' u-a ndes
I deh me afshín t' ím,
Kuror'e tufa lulja shpesh më ndrohet;
Kujtdo sa rron: martohet a po vdes
Prur gaz e ngushëllím.

Me mall sí pupëll flutura vjen shtríhet
Më puth, me kraht' sí mík më përkëdhel
Sí nj' í pandarë shok,
Dhe mbleta punëtore por sa gdhíhet
Sí prej ç' do lule-e meje mjaltë vjel
Më thíth e fletë-e flok.

Kushdo që vjen, í k' ênda t' í-a fal lulet
T' í prur në zemër prêhje dhe gëzím
Ç' do dhembje t' í-a shëronj,
E në kuxon díkush pa mênt e sulet
T' a shtjerë dorën egër për rëmbim
Më dhímpset t' a píckonj.

Jam për ç' do sy me dritë, lumtëria
Ç' do gaz í-a shtonj por dhe ç' do lot í-a shterr
Qoft punëtor a mbret,
Qysh plakut q' í përmêndet aq rísia
Qysh të sëmurít, — erën kush m'a merr
Fuqí ndjen dhe shëndet.

Jam Lulja-mbret e paqes s'ameshuar
Për ç' do njerí nga zemra që më dô,
Qëllímin q'e kupton ;
Dhuratë qjellí jam për botën çuar
Sí shênjë butësíje për këdô
Fatbardhësí q'êndrron !

BKSH

BKSH

LULE DHE GJÊMBA

BKSH

BKSH

SHQIPERIA ME 1914

«Kush êsht ay që shkel mi tokën shenjtë
Fytyr' e tij kë shpall tej rreze drite,
Porsi dh' agimi i njëj së kthjelltës dite
Kur prin n' atdhé me Flâmurin e shtrenjtë ?

Përpara tij, sa sheh, me drojë hiqen ;
Ç' do rrugë hapet, shënjë mrekullije,
Për qark dhe viset qeshin plot magjije
Si dheu e deti puthen e përpiqen!

Posht vargje! posht ju hekura të rênda
Mjaft, mjaft e ntrustë trupn' e Virgjëreshës,
U-nginj e dheu prej gjakut t'Arbëreshës,
Kushdo me thonj q' e çorri si-i doj ênda.

Gjëmim i fort shbërtheu nga trolli-e deti ;
Shqiptari, prej krahnorit, plot fuqije
Bërtiti mbushur hiri Perëndije:
«Me nder përunjuni se ardhi Mbreti»

. . . . . .

. . . . . .

Një lajm i ri në botë krejt buçiti
Me zê lajmtari popujt për t' i ftuar,
Në festën që Shqiptari u-a pati shtruar
Se dhe për 'tê një yll në qjell zu ndriti!

Sa gaz í pa dëftyer për ç' do zemër,
Po gaz që nuk tregohet dot në botë,
Të vdekurít u-ngjallnë — fjala thotë —
Ç'do frymë-e ndjen, sí mashkull edhe femër.

Ky komb jetík, burími që s' í díhet
Shkrímtarë qí me pendë gjíth të mprehta
I shtrudhën trutë valë-u rodhí jeta
Historianë-as emrí që s' u njíhet,

Me mjeshtëri-í përshkruan trímërítë
Zakonet e vetíjat e shqíptarít,
I-a njojtín gjer më pikë cílësítë:
Kujton síkur ky komb êsht nër të parít;

Vërtet se u-përpoq mê shum sa duhet
E njohtí vehten, mêndj' e tíj sa deshí —
Më kot një hístorí pra nuk po shkruhet:
Díkush se ç'farë robe mundí mveshí.

Po, dhe për 'të tíngllojnjë or' e mírë
Më kêmbë t' ecíj plak sado dhe n' íshte,
Fuqí të mbahet vetë, munt që s'kíshte
Por fatí kur të ndíh, nuk êsht vështírë!

Gjëmoj rreth toka, detí u-tmerrua
Të gjítha Mbretërítë krejt u-tundnë,
Dhe dípllomatët robat zun' í shkundnë
Sí për një nder të Plakut q' u-martua!

Dëfríme gazí, dítë kremtërímí
Porsí në dasmë kêngët nuk pushonín;
Rreth fqínjët helmít buzët í lëshonín
Kur shíhnín se për 'tà u-shojt qëllímí,...

Tomorrí, mal í shenjt' í Shqipërísë
Në valle hyrí bashkë me të rínjtë,
Sado në gjít që mbante Perëndínjtë
Sí gjysh, kujtoj prap vjetet e rísísë.

Po, dít' gazmore, qjellí buzëqeshte
Prej ândjes Plakun vêndí mê s'e nxínte,
Pà sende syrí í tíja që s'í dínte
Dhe petka që s'kísh mveshur po í mveshte.

Kurorë t' artë majë kres' í vunë
Mí trup me purpër bukur e stolísnë,
Mí fron shkëlqímí Dhëndër mír' e nísnë:
Çudí për 'tê, çudí për 'tâ kjo punë!

U-tundnë brítjesh lartësît qjellore
Gërnetat e lahutat mënt u-çanë,
Gjíthfar stolírash sytë se ç'u panë
Dhe flâmure me shkabën dykrenore.

Por kot! se Plaku foshnjej' í kísh mêntë —
Natura-ashtu í paskërka ndërtuar,
Atá që rrojtnë s'kanë për të rruar
Me gjíth q'e thomí: Zotí mos e dhêntë!

E thomí: «Zotí kurrë mos e dhêntë!»
Këtë-orë të pamshírët, orë tmerrí,
Se, besa, s'di në do t'na nxerë dherí
Në kokë prap në mos na-arthçín mêntë!

. . . . . .

Sëmundje-e vjetër — koha êsht pasqyrë
E shkuara ka fakte që s' mohohen,
Se veprat ameshímí në s' farrohen,
Por prapë krímbí-í prishjes u ka hyrë!

Shqíptarí êsht í bërë për të tjerë
Nga díturía, pasja, trímëría....
Se soje gjê s'ka parë Shqípëría
Përveç se trup e faqe thonjve çjerrë!

Stërgjyshrít sí me Lekën Math e Burrín
Në Babyllon' e Hínd u-shtruan gjêrë,
Romanët, keq u-drothnë që të têrë;
Greqís' së Motshme díç' í-a hêngër «grurín»!

Dhe Kartagjínën gjaku í yn' e lagu
Në Romë gjyshrít bênë me Qesarët,
Byzantí, Mbretër nesh pat nga të parët
Dhe díjetarë ballë-areopagu.

Hap Hístorín' e Ré, në do, të fqínjve:
Për 'tá vëllezrít shpata kryqësuan
Për Hênë dhe për Kryq nërmjét u-shuan:
Një trashëgím q' u mbet dhe sot të rínjve!

Me krahun t' onë kombe kemí ngjallur
Kafshitën vet nga goja u-a kemí dhënë,
Kur né gjíthmon pa bukë kemí qënë;
Aq sa me vehten t' onë jemí tallur!

Përçarja na ka qënë cílësija
Nga grindjet t' ona-armíku ka fítuar,
Dhe fatín vet me dorë-e kemí dbuar
Se puna duket: ç' mbet nga Shqipëría?

Gënjeshtra shkon atje ku munt të shkojë;
Për t' huajt bêhesh copë-e ke mëshírë,
Për vehte rrí me gísht në goj' í mpírë
Pra, mos u-qaj se roba s' ke dhe shtrojë!

Kur or' e zezë tingull sosje bínte;
Kur ré të tmerrta grumbull rrotull rínin
Shkëndíja sysh të gjaktë na shkreptínin;
Rrufé për vdekje zemrën na e grínte,

Aher' veç zum' e hapním sy e gojë
Sicilí bârín donte që t' í-a gjente,
Një míjë mëndje n' orë kush-do kthente;
Por, kush, s' të qet prej balte, në nevojë!

Me lot për faqe shkabën dykrenore
Për dhé të shkelur sí levere-e pamë,
Më kot me grushte kokës mjaft í ramë
Por dalje s' kísh nga bíshat shpírt mízore.

Vëllezrít e njëj même dhe njëj atí
Nërmjet armíq, qysh akull zemrat ftohur
Me gjíth që më një djellë bashkëngrohur ;
Sí mjerë né ! na pat mallkuar fatí.

Nj' ashtu sí jemí ndâ në fara-e físe
Nj' ashtu sí grihemí për punë feje,
Na për t' í trashëguar këto vise
Jam në dyshim, ju lutem «m' epní leje !»

Nuk dí në jemí burra-a veç një híje
Nuk dí, munt or' e vdekjes q'ësht afruar,
Se gazít për një çast q' í-a patmë shtruar :
S' ísh gaz, por një mallkím ísh Perëndije !..

1914

BKSH

U-VRA THOMSONI!

U-vra Thomsòni, u-vra Thomsoní
Ky zê plasí sí rrufè,
U-vra Thomsoní, u-vra Thomsoní
Ra për Flamur edh'Atdhè!

U-vra Thomsoní, sí trím me vlerë
Për të Flâmurít lavdím, —
Dëshmor í Kombít sí aq të tjerë
Që dëshmuan për shpëtím!

Tí Flamur ul-u sot híjes tíja
Dhe tí Komb që të shërbeu,
Atíj që drite lëshoj shkëndíja:
Për ju jetë që s'kurseu!

Me lot Shqíptarë, me lot e qaní
Për ju, trímín që ka rà,
Nër zemrat burra për 'të zí mbaní
Së dëtyren pas s'e là!

I bukur shêmbëll për shumë veta
Q'adhurojnë një lírí,
Me nder që bíjen pa-u dhembur jeta:
Një thesar për ç'do njerí!

I huaj s'qè pra në tokën t'onë —
Se Shqíptarít zemër kísh,

Veçse at' zemër nè për gjithmonë:
Le t' a njohim e kujt ish!

Një plumb i ardhur tej prej njëj dore
Të njëj trurit që s' mendon,
I dalë kryes tij shpirt-mizore
Atdhè ç' është që s' gjykon!

U-vra, por na sot, s' i-a dijmë çmimin
Të njeriut që vjen na çmon,
As që t' a shquajm' nuk mundim trimin
Prej atij që tradhëton!

Ky gjak i shtrenjtë për na që rodhi
Drejt në vesh gjith na tingllon:
«Siç' un' s' u-lodha, dhe ju mos lodhi
Se atdheja ndryshe s' rron!»

Pra dilni zotër, për vet luftoni
Veç si burra për nj' atdhè,
Por dhe vdisni siç' vdiq Thomsoni
Për Shqiprinë q' u ka lè!

15 Qershor 1914

MENDJESHKURTET

Jan' e ndodhen shumë veta
Që gjykojnë veç të tjerë...
Sa për 'ta, mor' tungjatjeta:
Mbaj-e gojën se të «*therë*»!

Jan' a bêhen mêndjeshkurtë
Thellë s'hynj për t' i veshguar;
S' u del gojës fjal' e urtë:
Djaj a shênjtër me t' u-ndruar!

Çpifín, tallen, si t' u vijë;
Për 'tâ vlera, karakteri,
Si virtut' a pun' e dijë
Janë ngjyra njëj ylberi!

Pakëz ndjenjat me t' u krojtur
Brênda cmiri do t'u gjendet,
Fjalë rruge duk' u hojtur
Qysh pas ândjes shohin sendet!

Truri i tyre, tru i ngushtë
Ja zu brymë si në vjeshtë,
Ja ka rrudha por si rushtë
Q' i than djelli von në vreshtë!

Më ç' do lule gjejnë morra;
Për 'ta drita paska njolla,
Se bilbilet janë sorra
Dhe se plepi bêka molla!

Gjakun s' dí në trup e rrêmba
N' e kan' ujë apo shëllírë,
Mos në trut u ríten gjêmba ;
Mos pa verë janë pírë !

Gojës jargët kur u dalín
Mê të ndyrat t' í spërkatín;
Ty gabíme nuk të falín
Krye-e-kêmbë, sysh të matín !

As pak vehten s' e pyesín
As që shíhen në pasqyrë,
Pa turp gjepura mos shesín :
Shpírt mos kanë mê të ndyrë !

Hanë bar a gjethe dushku
S' e vras mêndjen n' u ka hije,
Fríkë s' kam nga shkelmë mushku
Që s' dí kêmbët ku í shpíje !

Nëpër shoshe po u-a shkove
Veprat tyre-e jetës têrë ;
Do të shohç se, n' í kuptove:
Bêjtín n' ujët nga një vêrë !

Botën, thonë, q' e ndërtojnë —
As po ujku që t' í çajë,
Me ató q' atá mendojnë :
Uji-í detít s' munt t' í lajë !

HYMN HÊNES!

Hên' e verdhë, hên' e bardhë
S' je as mollë, s' je as dardhë,
Por je tokë pa një flagë
Plot me rrudha, plot me plagë.

Hên' e artë, hên' e-ërgjênttë
Se ç' í morre botës mênttë,
As e bukur as me híje:
Faqe shtrige plot me líje.

Kot të thonë se je vashë
Ty sy djall e kokë-trashë;
Kur vjen rrotull na sbarth dhêmbët
Sí kukùth, t' u-thefshín kêmbët!

Djemt e vajzat q' ëndërrojnë
Sí fatore t' adhurojnë,
Kur me pralla rín' u-k' ênda
Që t' u-lozesh në shtrat brênda.

Magjístarët ty të shkelín
Mêndje-lehtët që t' í mjelín;
S' dí ç' të thonë, s' dí ç' të lypín
Buzë-e gojë kur përtypín!

Ca të falen, ca të luten
Ca për ty në zíhje futen,

Tí nxjer gjuhën goj'-tagare
Që t' u tallesh sí qyqare!

Herë nxíhesh sí një nêmë
Herë ndrítesh sa një lêmë,
Kur, sí drapër, shtrígë nate
Kur, gjysmake, sy-lugate!

Herë dukesh korë-e artë —
Se je mvarur më të lartë,
Po lugetrít gjíth arijnë
Syt' e faqet të t' i grijnë...

Të gjíth duall gënjeshtarë
Sí dashtnor' e vjershëtarë,
Më kot hymne ty të çohín
Se ty mírë nuk të njohín.

Po të díjnín tí se ç' jeshe
Gjak turrínjtë do t' í keshe;
S' do t' të bênín aspak lutje:
Do t' të çporrnín dh' aq mê tutje!

NAKAR

I

Pasqyrë, po të dua, copë copë
Më çast të bënj pa fare pik mëshire,
Se syvet mij ti dukesh porsi gropë
Që ke përpirë kaq të Bardha Hire!

Po mos të jeshe ti, si lum' kjo botë!
Më s' dinte kush, se rrudha ka nër faqe,
Se syt' i ka të shuar e të ftohtë:
Se ferrë-u-bë në që një manushaqe!

Tek ujët e kulluar pa pik valë
Dhe thellësirën t'ënde të pa-masë,
Sa veta s'kanë shkuar palë palë
Sa s' pé, plot gaz, a loti që t' u shkasë!

E di, se jeta dëndur teje mvaret:
Të rinjtë mbë të math i bën të mbahen —
Je ti q' i ndes a po q' i shuan zjaret;
Nakarit pleqt' i bën më keq të thahen!

Disave kupën rafsh u-a mbush me mjaltë
Të tjerve helmin u-a ngarkon me barrë,
Sikur të gjith nuk janë nga një baltë
A po se s' janë bijt' e botës mbarë!

II

Në kohën t' eme, sytë kur t' í shtínja
Më dukej se sí mua s' ka mê tjatër,
Aq orë kur përpara teje rrínja:
Harronja dy e dy se bêjnë katër!

Sí qengj prej gazít hídhesha përpjetë
Pa pírë-í dehur ísha me vet-vehten,
Besonja se të rít' í kam për jetë
Se híret për gjíthmonë do t' më mbeten.

Tash, kur heth syt' mby ty síkur s' jam unë
E dí, s' kam qên' í bukur sí-Adonís-í,
Por vesh mê s' mund të marr, sí ngjet kjo punë:
Prej líli që të dukem njê gdhë lísí!

Munt tí, besoj, ke pamjen magjístare
Q' e ndron pa-një pa-dy ç' do kryevepër,
A unë mêndjen do t' a kem qyqare:
Munt koka e-íme kungull êsht' a pjepër.

Nga né të dy ndokush êsht' í mallkuar —
E njoh se nesh një fajín do t' a ketë;
Ja tín' í bên këtô pa u-mênduar
Ja unë nga nakarí s' dí ç' bêj vetë!

DASME!...

Mí një pullás shtëpíje
Po mjaurísnín tok,
Të djegur dashuríje
Një mace-e një maçok!

Me flokt' e ngrehur gjêmbë
Me syt shkëndíja plot,
Maçoku trí pëllêmbë
Prej zjarrít bíshtín lot.

Dhe macja sí ç' do mace
Ndë zemrët ka një mall,
Sí ndjenjat e ç' do race
Kur píqen ball për ball.

Kur êmbël e kur trashë
Seícilí mjauris,
Kur, sytë levarashë
Pa reshtur í lëvís!

Maçoku her' í sulet
Sí një që ndjehet zot,
Por thonjsh ajo í çkulet:
Sí dreqí trupín lot!

— Të dínja mík të mírë
Po jo të bêsh kështúú;

I thoť ajo e dlírë
Dhe gojës nxjer një „pfúú!"

Ay do prap t' í hídhet.
Sí djallí syt' í lot,
Por mbahet prap e mblídhet
Síkúr mê s' êshtë zot!

Por shpejt e kap për fytí —
Për tê mëshírë s' ka,
Për pak e díç' e mbytí
Nër thonjt' e tij kur râ!

— S' më do tí míke mua
A s' jam í bukur? uáá!
Ajo tha: Mê s'të dua,
U-hoq e thírrí: mjáá!!

BKSH

FYTYRE

Rri i vdekuri mi shtrat i shtrirë
Rreth tij qirinjtë ndezur flenë,
Nga dal u tretet dyllí-i ngrirë :
Si lotte pikat posht' u venë!

E verdhë drita e qirirít
Të verdhë duken rreth sa rrinë,
Për qark vështron të zit' e ullirit
Plot helmit muret shtojnë zinë!

Me lot për faqe grat' e qajnë
Me duart trupit kryqthi ndehur,
Të qarët radhas po i-a mbajnë
Gjith kryet ulur, sytë mfshehur!

Si pa kuxim nëpër dritare
Një rreze-e dobët u-ndrin faqet,
Porsi një shpresë udhëtare
Në shpirt të mûndurve që çfaqet!

Kandíli-i korës djek i qettë
Si sy prej kohës i pa lodhur,
Për drejt shênjtorí mjekrë-mprehtë
Mi fron po tallet duk'u-çlodhur!

Nga kísha râmjet e këmbanës
Rythmike derdhen plot trishtimí;

Me kryet unjur rrugës anës
Vajtojnë shelgjet prej pikllimi !

Ay, i ftohtë s' trêmbet fare
Po rri sy-shtrembër si kur tallet ;
Sheh mirë jeta gënjeshtare
Si shduket para se të çpallet !

BKSH

PASQYRA

Kurrgjê nuk jam në botë!
Një veglë jam pa shpírt e jetë
Një qelq, sí gur í ftohtë,
Zílí ndokush as munt të ketë:
Veçsè në qoftë mêndje-lehtë.

Njerí, s' trazonj me dorë —
Se duar s' kam, as kêmbë e gojë,
Jam varur mu sí korë,
Me prek me dorë kush të dojë
Dhe s' dí se sí të më nderojë.

Të gjíth kujdes më kanë
Me venë tek u vjen mê mírë;
Me mbajn' e shtratít pranë
Për dita faqet duk' m' í fshírë
E bukur t' jem sí vajzë-e dlírë.

Sa veta që m' afrohen
Të gjíth më vijnë duke qeshur;
Kur mvíshen a kur ndrohen
Shpesh, kur í shoh edhè të çveshur
Më kqyrín êmbël, buzë-qeshur!

Mê tepër e mê dêndur
Shoh zonj' e vajza kur ndërtohen;
Dhe burra shoh të çmêndur

Përpara meje që t' harrohen;
Të zbardhin dhëmbët, shtrembërohen.

Por fajin s' e kam unë
Në dashkan që të përkëdhelen
Dhe s' kanë nonjë punë;
N' u k' ënda dit' për dit' të çelen
Mëri s' u mbaj gjër sa të velen!

Po ku më ze çudija,
Për ca që kohën e humbasin!
Dhe zjarr n' u merr shtëpija
I shoh së kokën as e vrasin:
Po shpesh, dhe vehtes zjarr i kllasin!

BKSH

„NUSJA E MBARE!“

Buzëkúqurës

Tír-e leshtë-e Bardha Nuse
Mer shtëllungen se shkon vera,
Ler-í fjalët se na krruse
Se-e ke dímrin mun te dera!

Bagëtín' e ke përjashta
U-myk barí nër luadhe,
Dhe në lêmët kalbet kashta
Tí po mbahesh zonj' e madhe!

S' bêhet kurrë puna vetë
Lypset vêndít pak të tundesh;
Mbet lakrorí me një petë
Tí po krihesh e po shkundesh!

Nxír unazat, merr gjílpërën
Dhe qep línjat për fëmíjën
Qít-í rrathet, përvísh llêrën
U laj petkat që t' u ndríjën!

Nër të huaj burrí tretet
Tí po ndreqesh me të kuqe,
Tjatër send ty mê s' të mbetet:
Veç për díta sí burbuqe!

Gjíth me djersa dhe mundíme
Të mban murgu me të holla,
Tí nër êndje dhe gëzíme:
Kur me rrushka kur me molla!

Me pasqyrën gjíth në dorë
Mbet shtëpíja e pa fshírë,
Tí po zbardhesh por sí dborë
Enët, vatra blozë nxírë!

Shko në magjet e bêj bukë
Shíh se brumí t' u-thartua;
Shtëmbat thahen dhe tí nukë
Del për ujë gjer në krua!

Ç' pret t' êt-vjerrë plakë-krrusur
Ngreh-u zonjë, punën bêj-e,
Mos rrí zemrës duk' í-u lusur
Dashuris' edhe ç' do gjêje!...

Tí s' dí fare ç' thotë fshatí
M' í dreth flokët laqe laqe,
Por, gjíthmonë s' të ndíh fatí,
Se s' do kesh mê sy e faqe!

NGA BOTA E PRRALLAVE

BKSH

BKSH

MBURIMI I TE KEQIJAVE

Pandora, që në botë-e para grua
Prej dorës së Vullkanit e gatuar;
Minerva bukurit' i-a pat kushtuar:
Kurorë-e lule, t' ecur si pallua.

Prej Hyjve nj' arkë - asaj i-u dorëzua —
Ku të këqijat qênkeshin shiluar,
Dhe-Epimetheut shoqit të lakmuar:
„Mos hapet kurrë" - ish fjala q' i-u betua!

Por burri me t' i-a parë pajën, rendi
Mer àrkëzën, e hap pa kurrnjë leje —
Të shohë ç' dreq kish; mêndja siç' i-a endi.

S' besoj se bota bije keq në preje —
Se duall të këqijat, u-shkel besa....
E mbylli; por në fund kish mbet veç Shpresa!

SYT' E ARGUS-IT

Me sy një qint, ish Argusi-i pajuar
Pesdhjetë syresh hapur për nga herë,
Si rojë-e Jo-së ndruar në mëshqerë;
Gjê që Junona-atij i-a pat ngarkuar!

Me fyellin Merkuri i-a kish shtruar
Aq' sa në gjumë rojën e pat shtjerë!
Fët magjistari kryet i-a pat prerë;
Kur arth Junona mbet si nj' e hutuar!

I-a merr pra syt me dorën saj hyjnore
Mi bishtin e pallojit radh' i ngjiti
Mi bisht të shpesës bukur sy-qjellore!

... Symbol' i tija na tregon gjê tjatër —
Si ç' bota shënjësin' e tij e priti:
Se për ç'do send, syt lypset t'i kesh katër!

FYELLI I MINERVES

Minerva ríj një ditë me fyell e këndonte
Me zê hyjnor si nj' êngjëll plot mburrje hyjësore,
Junona dh'Afrodita, sicila po dëgjonte
Këndimin aq të bukur e plot magji qjellore.

Kur kêngës po í-a thoshte dhe gojën pak shëmptonte
Pâ, se Hyjeshat nisnë një qeshje krejt gazmore;
Minerva nga mëríja, pasqyrën sysh e çonte:
Kur pâ, prej goj' e flaku veglën fat-mizore.

Që posht e merr satyrí Marsya t' a shprovojë
Pa díjtur se këndimí fytyrën munt t' í-a ndrojë
Për fatn'e keq të tíjnë, besoj se që dhuratë !...

Me gjíth që s' prur një fyell as lè një pik shëmptimí
Por, burrít veç'í k' ênda—se duket êsht mê trímí;
Pësimit të Minervës dhe sot í ruhen gratë!

NARQISI

Te një lendinë mali me breth e lis qarkuar
Që një mburim me famë pa reshtur që mburonte,
Me nj' ujë-ërgjênd i pastërt, se vesa m' i kulluar
Sa ç' do rrugtar pa dashur një grim' aty qëndronte.

Një çun bari, Narqisi, sa her' aty që shkonte
Prej bukuris' së vettë po tretej si-i hutuar,
Aq sa për çast fytyrën vij n' uj' e pasqyronte
Gjer sa i-u bê sëmundje. pa bar, per t' i-a shëruar.

Ehko-ja Nymfë-ushtore, keq syrin i-a pat vênë!
Por s' di, bariu i mjerë në lule qysh u-ndrua;
Në lule ngjyrë-verdhë, në lule shênjë zije!

Për mallin e djaloshit në vojtje q' e pat shtênë
Më kot jehon Ekho-ja dhe sysh derth lotte prrua:
Se flî së bashkut ranë prej malli, bukurije!

DENIMI I PROMETHEUT

Lot derthte Prometheu, kur i mbërthyer
Shqiponja vij mëlçinë që t' i-a grinte,
Si kokra prushit sysh atô i shtinte :
Për fajn' e zjarrit qjejsh q' e pat rëmbyer !

Prej baltës dheut njerinë me t' a kryer
T' i falë frymë jete doj, t' a ngrinte ;
Minerva me ç' do send atij i ndihnte
Të bëjë soje atê q' e pat pandyer !

Vullkani si pas urdhrit t ' Jupiterit
Në majë të Kaukasit vênd i gjeti ;
Tridhjet mij' vjetsh dënim, sa jet' e Ferrit !...

N'u-fal, tridhjetë vjet gjith vojti-i shkreti !
Kur arth Herkuli faljen t' a zbatojë :
U-pâ, se munt dhe qjelli të gabojë ! !

BKSH

PËRMBLEDHJA E LËNDËS

Vjershave të mija . . Faqe 5

FLAGA E VATRËS

Gjuha Shqipe . . . Faqe 9
Hymn Kombëtar . . « 11
Mall Vëllazërije . , « 13
Adriatikut . . . « 15
Maleve T'anë . . . « 17
Flamur Ti Të Rrosh! . « 21
Letrë Prej Katundit T'em . « 22
Durrësi . . . . « 26
Fjala e Dodonës . . « 30
Apollonia . . . . « 31
Hymni i Festes . . « 33
Vlorës . . . . « 36
Marshi i Djalërisë Shqiptare « 40
Të Rinjve . . . « 42
Burri i Dheut . . . « 43
Luftari Lypës . . . « 58
Vdekja e Byron-it . . « 61
Pyrrhus et Cinéas . . « 63

VALLJA E JETËS

Ora e Zemrës . . . Faqe 67
Excelsior! . . . « 69
Hyji i Harruar . . . « 72
Afrodita . . . . « 74
Fialë në erë . . . « 76
Mêma . . . . « 78

PYSH

Lulja e Zemrës . . . Faqe 82
Lutje . . . . « 80
Ballada e Bariut . . « 84
Lutje e Vonuar . . . « 86
Hija e Keqe . . . « 88
Mos Humbni Shpresë! . « 98
Kotësia . . . . « 100
Këndô-më Çun . . « 102
Shih si Endet Bota... . « 103
Mister! . . . . « 105
Pendim Egoisti . . « 107
Juda i Ri . . . « 110
Lulet e Gjirit . . . « 114
Rrugtarët . . . « 115
Kênga e Udhëtarit . . « 116
Mëkati i Fshehur . . « 117
Shega . . . . « 120
Baresha . . . . « 126
Fytyrën T'ênde . . « 127
Dëshirë Pagane . . « 128
Kujtime të Shkuara . . « 132
Venediku . . . . « 133
Paqjes . . . . « 134
Serenada e Schubert-it . « 135
Paradokse . . . « 136

NGJYRA YLBERI

Mir'se Na Erdhe Prêndverë Faqe 147
Pamje . . . . « 149
Ylberi . . . . « 151
Stinat . . . . « 153
Qyqja . . . . « 155
Vegim Perëndimi . . « 158
Ruzollimi . . . « 160

DASH

Shi po Bije! . . . « *163*
Lulja e Këputur . . « *164*
Një Udhëtim... . . . « *166*
Fyelli . . . . « *171*
Andje Verore . . . « *174*
Vaje e Pyllit . . . « *178*
Mërzi Vjeshte . . . « *181*
Trandafili . . . « *185*

LULE DHE GJÊMBA

Shqipëria më 1914 . . *Faqe 191*
U-Vra Thomsoni! . . « *197*
Mêndjeshkurtët . . . « *199*
Hymn Hênës . . . « *201*
Nakar . . . . « *203*
Dasmë!... . . . . « *205*
Fytyrë . . . , « *207*
Pasqyra . . . . « *209*
«Nusja e Mbarë» . . « *211*

NGA BOTA E PRRALLAVE

Mburimi i Të Këqijave . *Faqe 215*
Syt' e Argus-it . . . « *216*
Fyelli i Minervës . . « *217*
Narqisi . . . . « *218*
Dënimi i Prometheut . « *219*



VEPRA TE BOTUARA:

Rreze Djelli vjersha 1904 me 224 faqe

Êndra e Lote « 1912 « 250 »

Psallme Murgu « 1930 « 224 »

BKSH

BKSH



BKSH